



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 615 Akti

Nr. 772 Vendimi  
Tiranë, më 5.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Relatore
<b>Etleđa Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 3.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Fatime Deçolli**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

**1.** Subjekti i rivlerësimit Fatime Deçolli, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

**2.** Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

**3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Fatime Deçolli do t’i nënshtruhej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.

**4.** Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Fatime Deçolli, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

**5.** Subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar<sup>1</sup> mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

**6.** Në datën 22.5.2024, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Fatime Deçolli për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e saj brenda datës 30.5.2024 nga marrja e njoftimit

---

<sup>1</sup> Referojuni *email*-it të subjektit dhe deklarimit të saj (dokument *attach*) datë 31.1.2021.

me postë elektronike, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 22.5.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit. Në datën 30.5.2024, subjekti dërgoi në rrugë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 31.5.2024, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Fatime Deçolli në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 31.5.2024, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 3.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Fatime Deçolli u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Fatime Deçolli. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 3.6.2024, për të rifilluar më 5.6.2024 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

11. Znj. Fatime Deçolli ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, konform nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës

Kushtetuese<sup>2</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**13.** ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Fatime Deçolli, me nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2019, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ku më parë subjekti, në datën 29.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**14.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklarinimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

---

<sup>2</sup> Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultun se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

**15.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**16.** Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 29.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

**17. Llogari rrjedhëse e pagës në Credins Bank, me gjendje në datën 28.1.2017 në vlerën 690,70 lekë.** Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>3</sup>.

**17.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.

**17.2** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se Credins Bank<sup>4</sup> ka informuar se subjekti i rivlerësimit është kliente pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë në datën 30.1.2017 është 690,7 lekë. Nga analizimi i *statement*-it Komisioni konstatoi se në këtë llogari kreditohet paga dhe se deklaratimet e subjektit përputhen me të dhënat e administruara nga institucioni bankar, duke mos konstatuar ndonjë problematikë lidhur me këtë llogari rrjedhëse.

**Deklarimi i bashkëshortit të subjektit, i cili si person i lidhur me subjektin ka deklaruar pasuritë si vijon:**

**18. Godinë banimi dykatëshe në Berat, z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, ZVRPP Berat.** Përfutuar me trashëgimi dhe blerjen e 5/6 pjesë të trashëgimtarëve bashkëpronarë, në vlerën 200.000 lekë (bashkëngjitur vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.5.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 8.6.2005, i noterit L. I). Vlera është 3.000.000 lekë, sipas vlerësimit me vlerën e tregut, realizuar privatisht në momentin e regjistrimit në hipotekë. Pjesa takuese: 100%. Ngarkuar me barrë hipotekore datë 1.10.2009 të noterit L. K për llogari të Emporiki Bank (sot Banka Amerikane e Investimeve), me qëllim garantimin e kontratës së huas bankare nr. \*\*\*, datë 1.10.2009, të noterit L. K (vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 5.10.2009, i ZVRPP-së Berat për pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2017, nga Credins Bank, sipas të cilit në emër të znj. Fatime Deçolli ka llogari page në vlerën 690 lekë (aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>4</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Vendim nr. \*\*\* regj., datë 6.5.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin T.D; kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 8.6.2005, sipas së cilës pala shitëse M.D, G.D dhe L.D i shet palës blerëse I.D pjesët e tyre të bashkëpronësisë në pasurinë godinë dykatëshe dhe

**18.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP Berat dhe ABI Bank.*

### **Hetimi i Komisionit**

**18.2** Rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, me përshkrimin “Banesë private dhe truall në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, në zonën kadastrale \*\*\*, me nr. \*\*\*, regjistruar në regjistrin hipotekor, f. \*\*\*, vol. \*\*\*, datë 9.6.2005, në emër të bashkëshortit, në bashkëpronësi të bashkëshortëve sipas ligjit. Vlera 3.000.000 lekë sipas vlerësimit të certifikatës së vlerësimit të ekspertës vlerësuese Xh. SH. Pjesa takuese: 50%. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar: *“Vlera e paguar për banesën në Mangalem sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 8.6.2005, në masën 200.000 lekë”*. Kjo pasuri rezulton e deklaruar edhe në deklaratën *Vetting* po në këtë shumë, me burim krijimi trashëgimi dhe blerjen e 5/6 pjesë të trashëgimtarëve bashkëpronarë në vlerën 200.000 lekë.

**18.3** Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit nëpërmjet Drejtorisë Vendore Berat<sup>6</sup> informon se nga verifikimi në sistemin ALBSREP rezulton se në pronësi të shtetasit I.K.D është regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit truall me sipërfaqe totale 117 m<sup>2</sup>, nga të cilat 59,6 m<sup>2</sup> ndërtesë, z. k. \*\*\*, Berat. Kjo pasuri është përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.6.2005.

**18.3.i** Kjo Drejtori ka depozituar pranë Komisionit praktikën e plotë të kësaj pasurie (origjinën e përfitimit, vendimin për çeljen e trashëgimisë, kontratën e shitjes, kartelën e pasurisë). Nga analizimi i dokumentacionit vihet re se pasuria ka qenë në pronësi të gjyshit të bashkëshortit prej vitit 1955.

**18.3.ii** Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nr. \*\*\*, datë 6.5.2005, rezultoi se është bërë çelja e dëshmisë së trashëgimisë, ku është përcaktuar pjesa takuese për secilin trashëgimtar. Pjesët takuese janë ndarë specifikisht: shtetasja L.T.K (D) (halla e bashkëshortit) në 3/6 pjesë; shtetasja M.S.D (nëna e bashkëshortit) në 1/6 pjesë; shtetasi I.K.D në 1/6 pjesë; shtetasja G.K.D (motra e bashkëshortit) në 1/6 pjesë.

**18.3.iii** Pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë rezultoi se është nënshkruar kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 8.6.2005, me palë shitëse M.D, G N/D dhe L.K/D dhe palë blerëse I.D. Çmimi i shitjes është 200.000 lekë.

---

truall me sip. 117 m<sup>2</sup>, nga ku 107 m<sup>2</sup> i zë godina, në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, e regjistruar me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, kundrejt çmimit 200.000 lekë, shlyer jashtë zyrës noteriale; certifikatë vlerësimi e ing. vlerësuese Xh. SH, datë 27.3.2006, për pronën banesë 2-katëshe dhe truall në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, me pronar I.D, sipas së cilës vlera e tregut me të cilën mund të shkëmbehet kjo pasuri është 3.000.000 lekë; planrilevimi + planimetri kati përdhe; kontratë hipoteke nr. \*\*\*, datë 1.10.2009, ndërmjet Emporiki Bank dhe palë hipotekuese I.D, F.D, për vënien në hipotekë të radhës së parë në favor të bankës të pasurisë së shtetasit I.D, truall me sip. 117 m<sup>2</sup> dhe godinë banimi 2-katëshe me sip. 107 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, për garantimin e huas së dhënë nga banka shtetasit I.D në vlerën 45.000 euro; dokumente identifikimi të hipotekuesve, certifikatë familjare; vërtetim nga dokumenti hipotekor i datës 11.6.2009, për pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall + godinë 2-katëshe, me sipërfaqe trualli 117 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 107 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Berat, në emër të shtetasit I.D (aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>6</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

**18.3.iv.** Komisioni, në analizë të të dhënave të përftuara nga hetimi, nuk konstatoi problematika në drejtim të deklaramit dhe mënyrës së përfitimit të kësaj pasurie.

#### **18.4 Lidhur me analizimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të shumës 200.000 lekë**

**18.4.i** Rezultoi se subjekti lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume, me pyetësin nr. 2, datë 23.10.2023, ka deklaruar se: “*Shuma prej 200.000 lekësh është krijuar nga të ardhurat nga paga e bashkëshortit si mjek në DRSKSH Berat dhe paga ime si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat*”.

**18.4.ii** Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e tyre nga punësimi përmbushin detyrimin e përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**18.5** Komisioni kreu analizën financiare në datën 8.6.2005, kur është investuar në këtë pasuri, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar për të gjithë familjen, sipas certifikatës së përbërjes familjare dhe pas përlllogaritjeve konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 100.457 lekë të investonte në këtë pasuri, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, duke i kaluar barrën e provës<sup>7</sup> për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

**18.6** Në qëndrim, subjekti ka parashtruar se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultonte se familja e saj në fund të vitit 2004 ishte me balancë pozitive në vlerën 435.943 lekë. Në analizën e dërguar për investimin e datës 8.6.2005 ka konstatuar se Komisioni e ka mbajtur të pandryshuar gjendjen *cash*. Subjekti shpjegon se në deklaratën e vitit 2004 ka deklaruar kursime *cash* në shumën 700.000 lekë dhe është mëse normale që i ka përdorur këto kursime për këtë investim. Për vitin 2005, ajo nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes *cash*, pasi nga muaji qershor deri në dhjetor shuma që është përdorur nga kursimet *cash* është zëvendësuar përsëri. Për sa kohë që dispononte të njëjtën shumë, nuk kishte se çfarë të deklaronte. Për sa kohë që analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2005 rezulton pozitive, provohet që subjekti i rivlerësimi ka pasur mundësi të kryejë investimin, si dhe të mbajë të pandryshuar kursimet *cash*.

**18.7** Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të administruara lidhur me këtë çështje, çmon të pranojë këtë kërkim të subjektit, pasi konstaton se: (i) shpjegimet e saj janë bindëse, pasi i gjen në harmoni me deklaramet e saj për kursimet *cash* në deklaratën periodike të vitit 2004 dhe zëvendësimin e këtij kursimi në vitin 2005; (ii) për këto vite nga analiza financiare subjekti i rivlerësimit rezulton në mundësi financiare për të mbajtur të pandryshuar kursimet *cash* – arrin në konkluzionin se provohet aftësia financiare e subjektit për të investuar në këtë pasuri, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

**19. Apartament banimi me kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 30.7.2009, të noterit Y. Ç, në adresën Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, me sipërfaqe të hipotekueshme 103,29 m<sup>2</sup>, me strukturë 2+1. Vlera e apartamentit është 82.600 euro, e cila paguhet në tri këste. Janë paguar:**

---

<sup>7</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**i.** Kësti i parë në vlerën 12.000 euro, paguar në datën 11.6.2009 me vlerën e llogarisë së depozitës në euro, datë 22.8.2007, me afat njëvjeçar, me interes 3.7% në vit, në Raiffeisen Bank (dega Berat), në emër të bashkëshortes Fatime Deçolli (V, S). Kredituar tërësisht nga llogaria rrjedhëse e pagës në Raiffeisen Bank e znj. Fatime Deçolli me nr. \*\*\* po në këtë datë, 22.8.2007 (bashkëngjitur vërtetimi datë 27.1.2017 i Raiffeisen Bank), si dhe paguar nga të ardhurat nga paga si gjyqtare.

**ii.** Kësti i dytë në vlerën 45.000 euro me kontratën e huas bankare nr. \*\*\*, datë 1.10.2009, të noteres L. K, lidhur nëpërmjet Emporiki Bank (sot Banka Amerikane e Investimeve) huadhënës dhe I.D huamarrës.

**iii.** Nuk është likuiduar kësti i tretë në vlerën 25.600 euro dhe nuk është bërë kalimi i pronësisë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>8</sup>.

**19.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga ABI Bank dhe DPPPP. Apartamenti nuk figuron i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë. Nuk rezulton të jetë kryer pagesa përfundimtare dhe nuk është bërë kontrata e shitjes.*

### **Hetimi i Komisionit**

**19.2** Rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, me përshkrimin “Kontratë sipërmarrjeje me “L” sh.p.k. për shitblerje ap. nr. \*\*\*, kati 5, banesë 7-katëshe, në rrugën “\*\*\*\*”, me vlerë 82.600 euro. Kontratë sipërmarrjeje datë 30.7.2009 para noterit Y.Ç. Paguar kësti i parë prej 12.000 euro nga depozita në Raiffeisen Bank dhe të ardhura nga paga. Paguar kësti i dytë me kredi nga Emporiki Bank në vlerën 45.000 euro sipas kontratës së huas datë 1.10.2009, nr. \*\*\* rep. të noteres L. K”.

**19.3** UKT-ja<sup>9</sup> informon se në emër të shtetasit I.K.D rezulton kontrata nr. \*\*\*, për objektin me adresë rruga “\*\*\*\*”, ish “\*\*\*\*”, Tiranë, me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë. UKT-ja ka depozituar edhe kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.7.2009, si dhe ID-në e shtetasit I.K.D (bashkëshorti i subjektit).

---

<sup>8</sup> Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 30.7.2009, sipas së cilës pala e parë, shoqëria “L” sh.p.k., merr përsipër të ndërtojë për palën porositëse I.D apartamentin nr. \*\*\*, me sipërfaqe të hipotekueshme 103,29 m<sup>2</sup>, me çmim 82.600 euro, në pallatin 7-katësh në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Dokumentacion i lejes së ndërtimit, sheshit të ndërtimit, planimetri etj.; marrëveshje për depozitë me afat datë 26.8.2008 në Raiffeisen Bank, në emër të znj. Fatime Deçolli, në vlerën 11.705 euro, me afat 12-mujor; vërtetim datë 27.1.2017 e Raiffeisen Bank në emër të znj. Fatime Deçolli; tabelë përmbledhëse e produkteve bankare në emër të znj. Fatime Deçolli; llogari page me gjendje në datën 31.12.2004/84.514 lekë, në datën 31.12.2005/870.341 lekë, në datën 31.12.2006/1.018.828 lekë, në datën 31.12.2007/481.587 lekë, në datën 31.12.2008/191.766 lekë dhe në datën 31.12.2009/252.924 lekë, në vijim me gjendje debitore. Çelur depozitë, datë 31.12.2007/11.327 euro, datë 31.12.2008/11.705 euro dhe datë 31.12.2009/0; depozitë *cash* datë 11.6.2009 nga BKT-ja, e kryer nga znj. Fatime Deçolli në shumën 11.000 euro, me përshkrimin “Pagesë këst apartamenti”, në llogari të shoqërisë “L” sh.p.k.; depozitë *cash* datë 12.6.2009 nga BKT-ja, e kryer nga znj. Fatime Deçolli në shumën 1.000 euro, me përshkrimin “Pagesë këst apartamenti”, në llogari të shoqërisë “L” sh.p.k.; depozitë *cash* datë 19.2.2010 nga BKT-ja, e kryer nga shtetasi I.D në shumën 300.000 lekë, me përshkrimin “Pagesë pjesore për shlyerje këst apartamenti”, në llogari të shoqërisë “L” sh.p.k. Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 1.10.2009, me palë kredidhënëse Emporiki Bank dhe palë kredimarrëse I.D e Fatime Deçolli, palë dorëzanëse “L” sh.p.k., të vlerës 45.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti me sip. 103,29 m<sup>2</sup>, referuar kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 30.7.2009. Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>9</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.



**19.4** FSHU-ja<sup>10</sup> informon se me gjeneralitetet I.D identifikohet 1 (një) abonent me kontratën e furnizimit nr. \*\*\* në instancën Tiranë. Nga verifikimi i të dhënave të kësaj kontrate rezulton se ajo është hapur më 5.1.2013.

**19.5** ASHK-ja nuk konfirmon nga asnjë prej drejtorive vendore Tiranë<sup>11</sup> pasuri të paluajtshme në emër të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj.

**19.6** Meqenëse pasuria apartament nuk konfirmohej e regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe nisur nga fakti që gjatë hetimit rezultoi e administruar vetëm kontrata e sipërmarrjes për këtë pasuri, Komisioni e ka pyetur<sup>12</sup> subjektin lidhur me ecurinë e procesit të nënshkrimit të kontratës së shitjes, si dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacion mbi statusin e kësaj pasurie.

**19.6.1** Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se: *“Sipas vërtetimit të ASHK-së datë 15.11.2023, me nr. \*\*\* prot. (verifikim për “L” sh.p.k.), si dhe vërtetimit datë 14.11.2023, me nr. 10847/2 prot. (verifikim për “D.K” sh.p.k.), pallati i ndërtuar në bazë të lejes së ndërtimit miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.6.2006, të KRRT-së Tiranë, ku gjendet apartamenti në të cilin banoj aktualisht (mbi bazën e kontratës së sipërmarrjes nr.\*\*\*, datë 30.7.2009), me sipërmarrës “L” sh.p.k. dhe ndërtues “D” sh.p.k., nuk rezulton i regjistruar ende. Po sipas këtyre shkresave, e njëjta situatë konfirmohet edhe për apartamentin nr. \*\*\* (në posedim prej meje sipas kontratës së sipërmarrjes). Lidhur me moshipotekimin e kësaj pasurie, sqaroj se shoqëria e ndërtimit, mbi kërkesën time si subjekt në proces vlerësimi sipas ligjit, ka lëshuar deklaratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2024, ku sqaron në lidhje me këtë situatë”.*

**19.6.2** Gjithashtu, Komisioni ka kërkuar informacion nga shoqëria “L” sh.p.k., e cila në përgjigje<sup>13</sup> ka sqaruar se objektit të pallati të ndërtuar prej kësaj shoqërie nuk i është mbaruar aktualisht procesi i regjistrimit fillestar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për shkak të problematikave që lidhen me pronën truall mbi të cilin është ndërtuar objekti. Shoqëria ka depozituar edhe dokumentacionin përkatës që lidhet me korrespondencat e mbajtura me zyrën e regjistrimit lidhur me aplikimet e depozituara për pajisjen me certifikata pronësie, si dhe aktverifikimin për plotësime të mëtejshme të dokumentacionit për llogari të këtij objekti në tërësi. Komisioni konstatoi se korrespondenca e fundit me ASHK-në datonte më 11.11.2023.

**19.7** Lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit të saj, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë<sup>14</sup> dhe

---

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021, e Drejtorisë Vendore Tirana Veri; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2021, e Drejtorisë Vendore Tirana Jug; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2021, e Drejtorisë Vendore Kamëz – Vorë, administruar në dosjen e Komisionit. ZQRPP-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen negative të ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon se znj. Fatime Deçolli dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasuri të regjistruara në emër të tyre. Aneks nr. 27 në dosjen e ILDKPKI-së. ZVRPP Tiranë, me anë të postës elektronike datë 1.2.2019, konfirmon se në emër të znj. Fatime Deçolli dhe personave të lidhur me të nuk ka pasuri të regjistruara. Aneks nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>12</sup> Pyetësor nr. 2, datë 23.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>14</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>15</sup> kanë konfirmuar se subjekti nuk ka gjykuar çështje civile/penale dhe nuk ka çështje/kërkesa civile ku palë të kenë qenë shoqëritë “L” sh.p.k. dhe “D” sh.p.k., apo administratorët e tyre, shtetasit A.B dhe K.B.

### **19.8 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament**

Rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se burim krijimi për këtë pasuri ka shërbyer: (i) depozita prej 12.000 euro në Raiffeisen Bank në emër të subjektit të rivlerësimit; (ii) kredia prej 45.000 euro e marrë pranë Emporiki Bank, sot ABI Bank. Komisioni analizoi dhe verifikoi secilin burim krijimi për ligjshmërinë e tyre.

#### **19.8.1 Hetimi i Komisionit lidhur me krijimin e depozitës në emër të subjektit të rivlerësimit në vlerën 12.000 euro në Raiffeisen Bank**

**i.** Nga korrespondenca e Komisionit me Raiffeisen Bank<sup>16</sup> rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur llogari rrjedhëse pranë kësaj banke, në të cilën i është kredituar paga prej nëntorit të vitit 2004 deri në qershor të vitit 2010.

**ii.** Nga analizimi i *statement*-it rezultoi se subjekti i rivlerësimit shumë e akumuluar prej pagave në këtë llogari e ka investuar në depozitë me afat. Më konkretisht, në datën 22.8.2007, shuma e akumuluar në këtë llogari prej 1.382.000 lekësh është konvertuar në monedhën euro me kursin e këmbimit të ditës, që i ka korresponduar vlerës 11.327,87 euro, dhe është investuar në depozitë me afat njëvjeçar. Në datën 22.8.2008, depozita është maturuar dhe janë përfituar 383,48 euro interesa. Në datën 26.8.2008, shuma 11.705 euro është investuar në depozitë (shuma fillestare plus interesat), e cila është maturuar në datën 26.8.2009 dhe janë përfituar 640,84 euro interesa.

**iii.** Komisioni kreu analizën financiare nga viti 2004 kur është hapur llogaria në Raiffeisen Bank deri në vitin 2008 kur është kryer investimi i fundit në depozitën me afat, pasi në vitin 2009 pas maturimit rezulton se është përdorur e gjithë shuma. Nga përlllogaritjet financiare të kryera Komisioni konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit gjendej në pamundësi financiare në shumën 84.220 lekë për të investuar në depozitë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

**19.8.1/a** Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se në analizën e kryer nga Komisioni duhet të përfshihen kursimet e nënës së bashkëshortit, pasi familja e saj ka qenë e përbërë prej bashkëshortit, dy fëmijët dhe nëna e bashkëshortit, dhe ajo gjatë hetimit ka dhënë shpjegime lidhur me të ardhurat e përfituara nga nëna e bashkëshortit, ashtu edhe për pasuritë në emër të saj. Sipas subjektit, në këtë kërkim të saj duhet të mbahen parasysh disa rrethana, konkretisht: (i) fakti që nëna e bashkëshortit nuk ka qenë subjekt deklarues/person i përfshirë në kategorinë e personave të familjes që duhet të deklaronin sipas ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, ndaj dhe nuk ka kryer deklarim për kursime të mundshme të saj; (ii) fakti se në pyetësin nr. 2 ajo ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2023, nga ISSH Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ku nëse përlllogariten të ardhurat e shtetasës M.D për vitet 2000 – 2008, ato rezultojnë të

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

kenë qenë në masën 1.412.301 lekë. Në këto rrethana, subjekti ka parashtruar se duke zbritur shpenzimet e jetesës 989.946 lekë provohet mundësia për kursim në vlerën 422.355 lekë, shumë kjo që mbulon balancën negative të rezultuar prej 84.220 lekësh.

**19.8.1/b** Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të administruara lidhur me këtë çështje, edhe pse konstaton disa fakte të tilla si: (i) rezulton e provuar se nëna e bashkëshortit të subjektit ka qenë në të njëjtin trung familjar dhe ka jetuar së bashku me subjektin e rivlerësimit; (ii) nëna e bashkëshortit nuk ka qenë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003; (iii) sipas vërtetimit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ rezulton se nëna e bashkëshortit ka pasur të ardhura, të cilat në raport me shpenzimet i krijojnë mundësinë të kursejë për mbulimin e balancës negative – vlerëson se në këtë rast nuk arrihet të përcaktohet<sup>17</sup> objektivisht mundësia e kursimit në masë/vlerë ndër vite. Këto rrethana, në proporcionalitet me faktet konstatuese sa më sipër arsyetuar, si dhe masën e balancës negative në shumën 84.220 lekë, nuk çmohen nga trupi gjykues me peshë të tillë që mund të përbëjnë shkak penalizues për subjektin për efekt të këtij procesi.

#### **19.8.1/c Lidhur me pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament**

**i.** Sipas kontratës së sipërmarrjes, pagesa e këstit të parë është kryer në datën 12.6.2009, në shumën 12.000 euro.

**ii.** Nga hetimi<sup>18</sup> rezultoi se kësti i parë është paguar në datat 11 dhe 12 qershor 2009, duke u depozituar shuma përkatëse në llogarinë bankare të shoqërisë “L” sh.p.k. në BKT, si më poshtë pasqyruar:

**Tabela nr. 1**

<b>Datë</b>	<b>Shuma në euro</b>	<b>Përshkrimi</b>
11.6.2009	11,000	<i>Cash deposit</i> Fatime Deçolli, pagesë kësti për blerje apartamenti
12.6.2009	1,000	<i>Cash deposit</i> Fatime Deçolli, pagesë kësti për blerje apartamenti

**iii.** Subjekti ka deklaruar se kësti i parë ishte paguar me depozitën në Raiffeisen Bank, ndërsa Komisionit i rezultoi se depozita është maturuar më 26.8.2009, ndërkohë që kësti i parë ishte paguar në datat 11 dhe 12 qershor 2009. Lidhur me këtë mospërputhje, subjekti përgjatë hetimit shpjegoi se për pagesën e këtij kësti është përdorur një hua e përkohshme.

**iv.** Komisioni, pasi verifikoi deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar, konstatoi se: *Subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua të përkohshme në deklaratën Vetting dhe në atë periodike, por e ka deklaruar në pyetësorin standard, ku në rubrikën e huamarrjeve ka deklaruar se: “Është marrë përkohësisht në qershor të vitin 2009 shuma 12.000 euro nga shtetasi L.K (kambist) për të paguar këstin e parë të apartamentit. Kjo shumë i është kthyer këtij shtetasi një pjesë brenda muajit*

<sup>17</sup> Edhe pse në analizën financiare të kryer nga Komisioni për familjen e subjektit janë përllogaritur edhe të ardhurat e nënës së bashkëshortit të saj.

<sup>18</sup> Aneks nr. 4/5 dhe nr. 35 në dosjen e ILDKPKI-së.

*qershor 2009 dhe pjesa tjetër në muajin gusht 2009. Ky veprim ka ndodhur për shkak se depozita që kisha në emrin tim në shumën 12.000 euro maturohej në muajin gusht 2009”.*

**v.** Nga verifikimi i llogarisë në Raiffeisen Bank në emër të subjektit të rivlerësimit rezultoi se në datën 26.6.2009 ishte transferuar shuma 8.000 euro në llogarinë e shtetasit L.F.K. Ndërsa në datën 26.8.2009, pas maturimit të depozitës, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e saj shumën 4.138 euro.

**vi.** Komisioni e ka pyetur<sup>19</sup> subjektin për të qartësuar pagesën e këstit të parë, si dhe për transferimin e shumës 8.000 euro shtetasit L.F.K.

**vii.** Subjekti në përgjigje ka sqaruar se meqenëse depozita e saj maturohej në muajin gusht, i është marrë hua shtetasit L.K shuma 12.000 euro. Më tej ka sqaruar se: *“Për shkak se shtetasi L.K më kërkonte kthimin e një pjese të shumës që më kishte dhënë hua që unë të paguaja kontratën e sipërmarrjes shoqërisë “L” sh.p.k., më është mundësuar financimi i shumës 8.100 euro në llogarinë time bankare në euro pranë së njëjtës bankë, nëpërmjet kredisë së datës 25.6.2009. Në datën 26.6.2009, shumën 8.000 euro e kam transferuar në llogarinë e shtetasit L.K. Në datën 26.8.2009 është maturar depozita në shumën 12.435 euro, me të cilën është mbyllur kredia e marrë, si dhe kam tërhequr shumën e mbetur prej 4.138 euro po në këtë datë, duke shlyer përfundimisht (dorazi) shtetasin L.K për diferencën e shumës 12.000 euro, të paguar prej tij. Për sa sgarova më sipër, kjo është edhe arsyeja e deklarimit në deklaratën periodike/vjetore 2009 dhe në deklaratën e rivlerësimit se burim për pagesën e këstit të parë prej 12.000 euro është depozita në Raiffeisen Bank, e krijuar nga ardhurat e mia nga paga”.*

**viii.** Në mbështetje të deklarimit, subjekti ka depozituar:

- kontratë huaje në llogarinë rrjedhëse për individët, datë 25.6.2009, lidhur ndërmjet Raiffeisen Bank sh.a. dhe znj. Fatime Deçolli, për shumën 8.100 euro;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2024, dhënë nga shtetasi L.K në cilësinë e ortakut të shoqërisë “R” sh.p.k.;
- ekstrakt historik mbi regjistrimin e biznesit të shtetasit L.K, nxjerrë nga QKB-ja, për aktivitetin e shoqërisë “R” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, ortak i vetëm shtetasi L.K;
- vërtetim nga DRTatim-Taksave Berat;
- nxjerrje llogarie bankare (*old statement*) për vitin 2009 të shoqërisë “R” sh.p.k., si dhe të shtetasit L.K nga Raiffeisen Bank sh.a.

**ix.** Komisionit, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar, i rezultoi se:

- Shtetasi L.K, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “R” sh.p.k., në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.1.2024, deklaroi se prej vitit 2007 e në vazhdim ushtron veprimtarinë tregtare si ortak i vetëm i kësaj shoqërie, me kapital fillestar 2.700.000 lekë. Gjatë vitit 2009, për shkak të ushtrimit të kësaj veprimtarie tregtare si kambist, ka pasur mundësi dhe i ka dhënë hua shtetasit I.D, i njohur prej tij si bashkëqytetar beratas, shumën prej 12.000 euro, në datën 11.6.2009. Këto shuma (ka deklaruar ai) i përkisnin shumave të cilat përdorshin nga ana e tij gjatë veprimtarisë si kambist. Ai ka deklaruar gjithashtu se

---

<sup>19</sup> Pyetësor nr. 2, datë 23.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

shuma 12.000 euro i është kthyer plotësisht prej tyre, një pjesë pas dy javësh nëpërmjet bankës dhe pjesa tjetër *cash*. Po ashtu ka deklaruar se shtetasit I.D dhe Fatime Deçolli nuk kanë asnjë detyrim ndaj tij si person dhe as ndaj shoqërisë “R” sh.p.k.

- Ekstrakti historik për shoqërinë “R” sh.p.k. pasqyron se kjo shoqëri është themeluar në vitin 2007, administrator është shtetasi L.K dhe ka objekt veprimtarie këmbimin valutator etj.
- Huadhënësi ka një numër të konsiderueshëm transaksionesh në llogaritë e tij. Nga verifikimi i transaksioneve të kryera për vitin 2009, konkretisht deri në 11 qershor kur është dhënë huaja, rezulton se shtetasi K ka tërhequr nga llogaria e shoqërisë “R” sh.p.k. shumën 263.796.676 lekë dhe nga llogaria e tij personale shumën 18.537.200 lekë.
- Subjekti ka nënshkruar me Raiffeisen Bank kontratën e huas në llogarinë rrjedhëse për individët me kolateral depozita me afat pranë Raiffeisen Bank, në datën 25.6.2009, për financimin e shumës 8.100 euro.
- Në datën 26.6.2009, subjekti ka transferuar nga llogaria e saj në Raiffeisen Bank shumën 8.000 euro drejt shtetasit L.K.
- Pas maturimit të depozitës në datën 26.8.2009, në shumën 12.345,84 euro, pasi është shlyer kredia dhe interesat përkatës të saj, po në këtë datë subjekti ka tërhequr shumën 4.138 euro.

**19.8.1/ç** Komisioni në vlerësimin e kësaj çështjeje, duke konstatuar se: (i) kjo hua është marrë për një periudhë shumë të shkurtër kohore; (ii) është kthyer pjesa më e madhe e saj në rrugë bankare brenda dy javësh nga data e marrjes; (iii) është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin standard; (iv) përfitohen të dhëna mbështetur në prova për identifikimin e veprimeve të kryera; (v) aktiviteti i huadhënësit për shkak të veprimtarisë që ai ka, qarkullon shuma të konsiderueshme – nuk evidenton problematika mbi ligjshmërinë e kësaj huamarrjeje të përkohshme dhe besueshmërinë e deklarimeve të subjektit.

**Në përfundim**, Komisioni, duke çmuar faktet në tërësi, të cilat kanë mundësuar të verifikimin e deklarimeve të subjektit lidhur për pasqyrimin e vërtetë të kësaj situatë, çmon se në këtë çështje objekt vlerësimi nuk evidentohen shkaqe që mund të penalizojnë subjektin e rivlerësimit.

### **19.8.2 Lidhur me kredinë prej 45.000 euro të marrë pranë Emporiki Bank, sot ABI Bank**

**i.** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 në rubrikën e detyrime financiare, me përshkrimin “Kredi për blerje apartamenti nga Emporiki Bank, në vlerën 45.000 euro”.

**ii.** Gjithashtu, subjekti këtë kredi e ka deklaruar edhe në rubrikën e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme si burim për pasurinë, me përshkrimin “Paguar kësti i dytë me kredi nga Emporiki Bank në vlerën 45.000 euro, sipas kontratës së huas datë 1.10.2009, nr. \*\*\* rep. të noteres L. K”.

iii. Nga korrespondenca e Komisionit me ABI Bank<sup>20</sup>, kjo e fundit informon se shtetasi I.D ka llogari kredie në monedhën euro, të hapur në datën 1.10.2009.

iv. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar me deklaratën *Vetting*<sup>21</sup> kontratën e huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2009, lidhur mes Emporiki Bank (sot ABI Bank), huamarrësit I.D dhe dorëzanës Fatime Deçolli dhe shoqëria “L” sh.p.k. Në nenin 2 të kontratës citohet se: *“Të ardhurat e huas do të përdoren nga huamarrësi për financimin e nevojave të tij për blerjen e një apartamenti me sip. 103,29 m<sup>2</sup> të ndodhur në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, Shqipëri, në përputhje me kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30 korrik 2009, nënshkruar ndërmjet shoqërisë “L” sh.p.k. me cilësinë e palës së parë dhe I.D me cilësinë e palës së dytë, vërtetuar nga noter Y.Ç”.*

v. Për këtë kredi është lidhur kontratë hipoteke nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2009, ku hipotekë është vendosur pasuria e paluajtshme, godinë banimi 2-katëshe me sip. 107 m<sup>2</sup> dhe truall 117 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, ndodhur në lagjen “\*\*\*”, Berat. Këtë pasuri, e cila është vendosur hipotekë në emër të bashkëshortit të saj, subjekti e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

vi. Nga analizimi i *statement*-it rezulton se kredia është disbursuar në datën 7.10.2009 në vlerën 45.000 euro dhe po këtë ditë është transferuar shuma 44.290 euro në llogari të shoqërisë “L” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim nga I.D tek “L” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së kredisë”.

vii. Komisioni konstatoi se kredia është akorduar/disbursuar nga një institucion financiar, veprimet janë kryer me bankë dhe, për rrjedhojë, nuk konkludon në ndonjë problematikë lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi.

**19.9** Nisur nga analiza e burimeve të kësaj pasurie, për të cilat nuk u konstatuan problematika mbi ligjshmërinë e tyre, Komisioni kreu edhe analizën financiare për vitin 2009 për të parë mundësitë e subjektit për të shlyer dy këstet/pagesat, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, ku pas përlllogaritjeve konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të paguajë këstet e pasurisë apartament dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

### **19.10 Lidhur me pagesat e kryera për blerjen e këtij apartamenti**

**19.10.1** Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, përveç dy pagesave të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, të trajtuara më sipër, ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 se ka paguar 300.000 lekë, këst për shoqërinë “L” sh.p.k., nga gjendja *cash* e kursyer në vitin 2010.

**19.10.2** Nga hetimi<sup>22</sup> rezultoi se kjo shumë është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë bankare të shoqërisë “L” sh.p.k., në datën 19.2.2010, me përshkrimin “Pagesë pjesore për shlyerje apartamenti I.D (2.165 euro x 138,6 = 300.000 lekë)”.

---

<sup>20</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>21</sup> Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>22</sup> Aneks nr. 35 në dosjen e ILDKPKI-së, administruar në dosjen e Komisionit.

**19.11** Nisur nga fakti se kjo pagesë është kryer në shkurt të vitit 2010 dhe meqenëse në fund të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje *cash* në vlerën 2.500.000 lekë (dhe ky vit është mbyllur me balancë pozitive), Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të kryer këtë pagesë. Komisioni kreu analizën vjetore për vitin 2010, e cila rezultoi me balancë pozitive në shumën +830.348<sup>23</sup> lekë, duke mos konstatuar në këtë mënyrë pamjaftueshmëri financiare.

**19.12** Komisioni hetoi edhe në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit të saj dhe shoqërisë ndërtuese “L” sh.p.k., si dhe administratorit të saj, shtetasi A.B. Sipas shkresës se Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë<sup>24</sup> dhe shkresës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>25</sup>, nuk rezultoi që ndaj shoqërisë “L” sh.p.k. dhe shtetasit A.B të jenë dhënë vendime civile/penale nga gjyqtarja Fatime Deçolli, si dhe nuk ka çështje/kërkesa civile në gjykim pranë kësaj gjyqtareje ku palë të jenë shoqëria “L” sh.p.k. apo administratori i saj, shtetasi A.B.

**19.13** Komisioni hetoi gjithashtu në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në përfitimin e kësaj pasurie. Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, për vitin 2009. Sipas këtij udhëzimi, rezulton se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës, në zonën \*\*\* ku ndodhet pasuria e subjektit, është 102.500 lekë/m<sup>2</sup> sipërfaqe e shfrytëzueshme. Apartamenti i porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009 është me sipërfaqe 103,29 m<sup>2</sup>. Duke u bazuar në çmimet referuese, rezultoi se vlera e apartamentit është 10.587.225 lekë (103,29 m<sup>2</sup> x 102.500 lekë/m<sup>2</sup>). Kjo vlerë rezulton më e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është porositur/blerë në vlerën 11.330.242 lekë<sup>26</sup>. Në vlerësim të dhënave të dala, për sa kohë rezultoi se kjo pasuri është porositur/blerë më shtrenjtë sesa çmimet referuese, Komisioni nuk konkludoi mbi ndonjë trajtim preferencial të subjektit të rivlerësimit në porositjen e kësaj pasurie.

**20. Automjet tip “Mercedes-Benz E270CDI” me targë \*\*\***, blerë me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.1.2017, të noteres S. M.X. Tërhequr nga llogaria në Credins Bank nr. \*\*\*, vlera 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>27</sup>.

**20.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.*

## **Hetimi i Komisionit**

<sup>23</sup> Referojuni tabelës nr. 5 në materialin e rezultateve të hetimit administrativ.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2023, administruar me pyetësorin nr. 2, datë 23.10.2023, në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>26</sup> 82.600 euro konvertuar me kursin mesatar për vitin 2009 sipas Bankës së Shqipërisë.

<sup>27</sup> Kontratë shitblerjeje mjeti nr. \*\*\*, datë 27.1.2017 (aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së).

**20.2** Rezulton se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën *Vetting* dhe më pas në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, pasi pasuria është blerë në datën 27.1.2017.

**20.3** DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2021, informon se shtetasi I.K.D ka të regjistruar automjetin me targë \*\*\*.

**20.3.1** Kjo Drejtori ka depozituar dosjen e automjetit, ku rezulton se mjeti tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\* është blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.1.2017, me palë shitëse M.R dhe palë blerëse I.D, në vlerën 400.000 lekë.

**20.4** Lidhur me burimin e krijimit, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se ka shërbyer tërheqja e kryer në Credins Bank nr. \*\*\*.

**20.4.1** Nga verifikimi i llogarisë në Credins Bank, Komisioni konstatoi se në këtë llogari nuk rezulton të jetë tërhequr ndonjë shumë në datën e blerjes së mjetit apo ditë përpara. Komisioni i ka kërkuar<sup>28</sup> subjektit të qartësojë burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij mjeti, ku në përgjigje ka deklaruar: “*Sqaroj se për mjetin e blerë në datën 27.1.2017 ka shërbyer tërheqja nga llogaria në euro e bashkëshortit tim I.D në Credins Bank dhe jo llogaria në lek, sikurse kam deklaruar gabimisht*”.

**20.4.2** Nga verifikimi i llogarive duket se deklarimi i numrit të llogarisë në lek nga subjekti është një pasaktësi, pasi Komisioni konstatoi se në datën 27.01.2017 që është blerë mjeti, po në Credins bank janë tërhequr nga llogaria në monedhën euro, 4.000 euro.

**20.5** Komisioni kreu analizën financiare në datën e investimit dhe nga përlllogaritjet e kryera i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur mundësi të investonin në blerjen e automjetit, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

**21. Llogari rrjedhëse (në lek) në Credins Bank, me gjendje në datën 28.1.2017, në vlerën 761.647,15 lekë.** Krijuar nga vlera e shitjes së pasurisë së paluajtshme me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2016, të noterës F. Z (bashkëngjitur kontrata e shitjes, të dhënat mbi llogarinë rrjedhëse nga data 31.12.2016 deri më 30.1.2017 të Credins Bank). Vlera: 261.647 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>29</sup>.

**21.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur:

*i. Nga dokumentacioni i administruar në ILDKPKI, nxjerrje llogarie bankare<sup>30</sup> për periudhën 1.12.2016 – 31.12.2016 në Credins Bank, në emër të shtetasit I.D, evidentohet në datën 20.12.2016*

<sup>28</sup> Me pyetësorin nr. 3, datë 27.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>29</sup> Konfirmim nr.\*\*\* prot., datë 28.1.2017, nga Credins Bank, i cili konfirmon se shtetasi I.D ka llogari me gjendje në këtë datë 761.647 lekë; nxjerrje llogarie bankare për periudhën 19.1.2017 – 30.1.2017 nga Credins Bank në emër të shtetasit I.D, për gjendjen e mbetur prej 261.647 lekësh në datën 30.1.2017 (evidentohet tërhequr *cash* 500.000 lekë në datën 30.1.2017). Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* , datë 1.12.2016, me palë shitëse M.D dhe palë blerëse T.B, të apartamentit me sip. 84 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\* , vol. \*\*\* f. \*\*\* , në adresën lagjja “\*\*\*\*”, Fier, në vlerën 4.400.000 lekë, shlyer shuma nëpërmjet llogarisë bankare, ndërmjetëse të noterës F.Z, konkretisht shuma 20.000 euro, konvertuar në 2.700.000 lekë, si dhe shuma 1.700.000 lekë. Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>30</sup> Aneks nr. 38 në dosjen e ILDKPKI-së.



kalimi i shumës 1.699.439 lekë nga llogaria e personit fizik, noterës, në zbatim të kontratës nr. \*\*\*, datë 1.12.2016.

ii. Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Credins Bank, si dhe evidentohet kalimi i të ardhurave nga shitja e pasurisë së paluajtshme të nënës nga llogaria ndërmjetëse e noterës.

iii. Është deklaruar shitja e pasurisë nga nëna e bashkëshortit të subjektit, e cila ka lëshuar prokurë për shtetasin I.D, lidhur me pasuritë në emër të saj.

## Hetimi i Komisionit

**21.2** Credins Bank<sup>31</sup> informoi se shtetasi I.D është klient i kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezultoi se gjendja në llogarinë rrjedhëse në datën 30.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në vlerën 261.647,15 lekë. Në këtë llogari, deri në vitin 2013, bashkëshortit të subjektit i është kredituar paga.

**21.3** Lidhur me gjendjen e deklaruar në këtë llogari, rezultoi se ajo ka si burim shumën 1.699.439 lekë të kredituar nga llogaria e noterit publik F.Z, person fizik, me përshkrimin “Kalim sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2016”.

**21.3.1** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Llogari rrjedhëse në Credins Bank, me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 761.647 lekë. Burimi i krijimit nga shitja e pasurisë së paluajtshme në emër të mamasë time M.D, me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol.*”.

**21.3.2** Me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar<sup>32</sup>: kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 1.12.2016, me palë shitëse M.D dhe palë blerëse T.B, të apartamentit me sip. 84 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në adresën lagjja “\*\*\*\*”, Fier, në vlerën 4.400.000 lekë, shlyer shuma nëpërmjet llogarisë bankare, ndërmjetëse të noterës F.Z, konkretisht shuma 20.000 euro, e konvertuar në 2.700.000 lekë, dhe shuma 1.700.000 lekë; prokurë të posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.11.2016, në të cilën vërehet se shtetasja M.D autorizon djalin e saj I.D të administrojë dhe tjetërsojë pasuritë të cilat zotëron.

**21.4** Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se konfirmohet deklarimi i bashkëshortit të subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Credins Bank, si dhe evidentohet kalimi i të ardhurave nga shitja e pasurisë së paluajtshme të nënës nga llogaria ndërmjetëse e noterës.

**22. Llogari rrjedhëse (në euro) në Credins Bank, me gjendje në datën 28.1.2017, në vlerën 15.953,21 euro.** Krijuar nga vlera e shitjes së pasurisë me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2016, të noterës F. Z (bashkëngjitur kontrata e shitjes, të dhënat mbi llogarinë rrjedhëse për periudhën 31.12.2016 – 24.1.2017 dhe vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2017, i Credins Bank). Vlera: 15.953 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>33</sup>.

<sup>31</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>32</sup> Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>33</sup> Konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2017, nga Credins Bank, i cili konfirmon se shtetasi I.D ka llogari në vlerën 15.953 euro. Aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së. Nxjerrje llogarie bankare datë 24.1.2017 nga Credins Bank në emër të shtetasit I.D, në vlerën 19.533 euro. Aneks nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë shitblerjeje e pasurisë

**22.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Credins Bank. Dokumentohet kalimi i shumës, përfituar nga shitja e pasurisë nga llogaria ndërmjetëse e noterës. Është deklaruar shitja e pasurisë nga nëna e bashkëshortit të subjektit, e cila ka lëshuar prokurë për shtetasin I.D.*

### **Hetimi i Komisionit**

**22.2** Credins Bank<sup>34</sup> informon se shtetasi I.D është klient i kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se gjendja në llogarinë rrjedhëse në datën 30.1.2017 kur është depozituar deklarata *Vetting* është në vlerën 15.953,21 euro.

**22.3** Lidhur me gjendjen e deklaruar në këtë llogari, rezulton se ajo ka si burim shumën 19.954 euro të kredituar nga llogaria e noterit publik F.Z, person fizik, me përshkrimin “Kalim sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2016.

**22.4** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Llogari rrjedhëse në Credins Bank, me gjendje në datën 31.12.2016, në vlerën 15.953 euro. Burimi nga shitja e pasurisë së paluajtshme në emër të mamasë time M.D, me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2016, të noterës F. Z”*.

**22.5** Nga të dhënat e administruara rezulton se është e njëjta pasuri e shitur e trajtuar më sipër, porse të ardhurat nga shitja janë përfituar në dy valuta, në lek dhe euro.

**22.6** Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se konfirmohet deklarimi i bashkëshortit të subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Credins Bank, si dhe dokumentohet kalimi i shumës përfituar nga shitja e pasurisë nga llogaria ndërmjetëse e noterës.

### **Detyrimet financiare**

**23. Kontratë huaje bankare nr. \*\*\*, datë 1.10.2009**, e noterës L. K, lidhur ndërmjet Emporiki Bank (sot Banka Amerikane e Investimeve) si huadhënës dhe shtetasit I.D huamarrës, për vlerën 45.000 euro, për blerje apartamenti, financuar në vitin 2009 për një afat 20-vjeçar, me interes 9.23% (bashkëngjitur vërtetimi datë 25.1.2017 i Bankës Amerikane të Investimeve). Detyrimi financiar i mbetur është në vlerën 36.231,77 euro, deri në datën 25.1.2017. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>35</sup>.

---

së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 1.12.2016, me palë shitëse M.D dhe palë blerëse T.B, të apartamentit me sip. 84 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në adresën lagjja “\*\*\*\*”, Fier, në vlerën 4.400.000 lekë, shlyer shuma nëpërmjet llogarisë bankare ndërmjetëse të noterës F.Z, konkretisht shuma 20.000 euro, konvertuar në 2.700.000 lekë, si dhe shuma 1.700.000 lekë. Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>34</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>35</sup> Vërtetim nr. ref. \*\*\*, datë 25.1.2017, nga ABI Bank, i cili konfirmon se shtetasi I.D ka marrë një kredi hipotekore në vitin 2009 me afat 20-vjeçar, në shumën 45.000 euro, me detyrim të mbetur (*outstanding*) në vlerën 36.231 euro; kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 1.10.2009, me palë kredihënëse Emporiki Bank dhe palë kredimarrëse I.D e F.D, palë dorëzanëse shoqëria “L” sh.p.k., të vlerës 45.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti me sip. 103,29 m<sup>2</sup>, referuar kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 30.7.2009. Aneks informues 1, Aneks informues 2. Deklaratë; vërtetim nga dokumenti hipotekor në emër të shtetasit I.D për pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, regjistruar në datën 5.10.2009, me sip. 117 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”. Aneks nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

**23.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ABI Bank.*

### **Hetimi i Komisionit**

**23.2** Komisioni, këtë kredi, marrjen dhe qëllimin e saj e ka trajtuar më sipër në këtë vendim. Lidhur me detyrimin e mbetur pa shlyer, rezultoi se deri më 27.1.2017 ky detyrim është në shumën 36.231,77 euro. Komisioni konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ABI Bank.

### **23.3 Lidhur me shlyerjen e kredisë**

**23.3.1** Nga hetimi rezultoi se nga data e marrjes së kredisë subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore shumën e shlyer për çdo vit.

**23.3.2** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruarës: *“Vlera e kredisë në shumën 4.656 euro në Credins Bank është likuiduar nga llogaria personale e shtetases K.B (vajza e hallës) dhe është likuiduar plotësisht në janar 2017, fakt të cilin do ta pasqyroj në DPV-në e vitit 2017”.*

**23.3.3** Komisioni verifikoi deklarimin e subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, ku konstatoi se në rubrikën e detyrimeve financiare bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *“Kthyer shuma prej 500.000 lekësh K.B në janar 2017”.*

**23.3.4** Nga hetimi i kryer, pas verifikimit të *statement*-it në ABI Bank, ka rezultuar se shtetasja K.B ka likuiduar edhe këste të tjera të kredisë ndër vite. Komisioni i ka kërkuar subjektit<sup>36</sup> të sqarojë marrëdhënien me këtë shtetase, si dhe qëllimin e pagesave të kryera nga kjo e fundit. Subjekti në përgjigje ka sqaruar: *“Fillimisht dua të saktësoj faktin se vlera prej 4.656 euro nuk është paguar (derdhur) në Credins Bank, por në Emporiki Bank (sot ABI Bank), ku është lëvruar kredia për të cilën nga viti 2010 e në vazhdim (deri në vitin 2029) paguaj rregullisht këstet mujore sipas skedulit të amortizimit. Me shtetasen K.B jam vajzë halle (mamaja e K, e ndjera E.L, dhe babai im S.V/S janë motër e vëlla). Sqaroj gjithashtu faktin se pallati në të cilin unë kam porositur apartamentin me kontratën e sipërmarrjes (apartament)... është ndërtuar nga shoqëria “D.K”/investitori dhe “L” sh.p.k./ndërtuesi. “D.K” ka administrator dhe ortak të vetëm K.B, kurse “L” sh.p.k. ka administrator dhe ortak të vetëm A.B... Ndërkaq, sikurse rezulton nga të dhënat e deklaruara për mua si gjyqtare/subjekt i ligjit dhe të dhënat e bashkëshortit tim si subjekt i lidhur me mua, unë jam transferuar në Tiranë në pozicionin e punës gjyqtar nga Gjykata e Beratit në atë të Tiranës, në datën 1.4.2010. Kurse im shoq I.D është transferuar me punë më vonë, në vitin 2013. Edhe pas ardhjes së bashkëshortit tim dhe pjesës tjetër të familjes me punë në Tiranë, gjatë vitit 2013, ka vazhduar e njëjta marrëdhënie me K.B. Nga ana tjetër, ashtu sikurse deklarova më sipër, apartamenti është marrë në dorëzim nga ana jonë në vitin 2013. Kështu, për shkak të këtij historiku transferimesh, lëvizjesh nga një qytet në tjetrin, impenjimeve për t’u sistemuar në Tiranë, si dhe ngarkesës në punë, pagesat e kësteve të kredisë janë bërë nga ime kushërirë K.B, në kushtet e mundësisë dhe dëshirës për t’i ardhur në ndihmë familjes time, por theksoj vetëm fizikisht, meqë vlera e kësteve është rimbursuar gjithmonë, çdo muaj, sipas vlerës së kështit*

---

<sup>36</sup> Me pyetësorin nr. 3, datë 27.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

*respektiv. Vërtet pagesat e kësteve janë paguar nga K. për të respektuar datat e sakta të kësteve, por ato shuma janë kthyer nga unë, ashtu siç e kam deklaruar në çdo vit në deklaratat periodike principalin e paguar nga familja ime për këtë kredi. Ky fakt është deklaruar dhe pasqyruar në pakësimet e të ardhurave të mia në vite, në masën e vlerës së kësteve të kredisë, deklaruar në DPV-në nga viti 2009 e në vazhdim. Siç edhe kam deklaruar në deklaratën periodike/vjetore 2016, shuma 4.656 euro, shlyer nga llogaria personale e vajzës së hallës, K.B, është shuma e kësteve të kredisë që kjo shtetase ka likuiduar për vitin 2016 në Credit Agricole Bank, ku unë kam kontratën e kredisë bankare që nga viti 2009. Sqaroj se pagesat e kryera gjatë vitit 2016 nga shtetasja B. nuk i janë kthyer çdo muaj siç ka ndodhur gjithmonë, por ajo shumë është kthyer në vitin 2017, siç e kam deklaruar edhe në deklaratën periodike. Kreditimi me vonesë i pagës së bashkëshortit (mungesa e kreditimit mujor) ka bërë që pagesat mujore të kredisë nga ana e K.B të akumulohen duke u konsideruar hua deri në momentin e mundësisë financiare për kthim nga ana jonë”. Gjithashtu, në pyetësin nr. 3 subjekti ka sqaruar se: “Llogaria në lek ...është përdorur nga bashkëshorti im për shlyerjen e K.B, për detyrimin e vitit 2016, sikurse e kam deklaruar në deklaratën Vetting dhe në DPV-në përkatëse”.*

**23.3.5** Lidhur me këtë çështje, nga verifikimi i llogarive bankare Komisionit i rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij në lek në Credins Bank shumën 500.000 lekë, në datën 30.1.2017 dhe të nesërmen, në datën 31.1.2017, e ka depozituar këtë shumë në llogarinë e shtetasës K.B në BKT, me përshkrimin “I.D derdh në llogari detyrim kthim borxhi”.

**23.3.6** Komisioni kreu analizën financiare nga momenti i marrjes së kredisë, viti 2009, deri në vitin 2016, duke përfshirë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar. Për vitet 2013 dhe 2014, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pasurisë në qytetin e Beratit, në emër të bashkëshortit, pasi sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti konstatoi se pagesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga qiraja rezultonte e paguar në vitin 2018, pra gjatë procesit të rivlerësimit. Në vitin 2016 nuk janë përfshirë si shpenzim këstet e paguara për shlyerjen e kredisë, pasi ato janë paguar nga fondet e shtetasës K.B. Në këtë drejtim, Komisioni konstatoi se kjo shtetase është administratore dhe ortak e vetme e shoqërisë “D.K” sh.p.k., me datë themelimi 2.9.1996 dhe kapital 20.000.000 lekë. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se fitimi i shoqërisë “D.K” sh.p.k. për vitin 2016 është në vlerën 2.773.460 lekë. Gjithashtu, rezultoi se bashkëshorti i shtetasës K.B është administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “L” sh.p.k. Po nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kjo shoqëri për vitin 2016 ka realizuar fitim në vlerën 11.407.551 lekë. Në analizë të të dhënave të përfituara, Komisioni konstatoi se familja B. ka pasur burime të ligjshme dhe mundësi financiare për këstet e paguara gjatë vitit 2016.

**23.3.7** Nga analiza financiare e kryer për periudhën e analizuar, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën totale 412.377 lekë të shlyejë kredinë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare për vitet 2011, 2014 dhe 2015, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

**23.3.8** Në qëndrimin e saj, subjekti ka parashtruar se duhet të mbahet parasysh nga Komisioni mundësia e krijimit të kursimeve nga nëna e bashkëshortit të subjektit, për sa kohë ajo ka pasur të

ardhura dhe pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës ka pasur mundësi të kursejë. Sipas subjektit, po të kryhen rillogaritje duke përfshirë kursimet e saj, rezulton se mbulohen balancat negative të konstatuara për vitet 2011, 2014 dhe 2015. Subjekti ka ricituar provat e depozituara në pyetësinorin nr. 2 lidhur me të ardhurat e krijuara nga nëna e bashkëshortit të subjektit.

**23.3.9** Trupi gjykues, në analizë të fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ, shpjegimeve dhe provave të administruara lidhur me këtë çështje, duke konstatuar së ky pretendim është i njëjtë me atë të parashtruar në pikën 19.8.1/a të këtij vendimi, vlerëson të mos bjerë në përsëritje, duke u shprehur se vlen i njëjti arsyetim.

**23.3.10** Në përfundim, trupi gjykues, lidhur me pamjaftueshmërinë financiare ndër vite në shumën 496.597 lekë, edhe pse konstaton se nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë për periudhën 2000 – 2015 shumën 1.083.591 lekë, në kushtet kur nuk mund të përcaktojë ekzaktësisht masën e kursimit, vlerëson se kjo balancë negative, e shpërndarë në katër vite, 2008, 2011, 2014 dhe 2015, bazuar në parimin e proporcionalitetit sipas jurisprudencës së Kolegjit<sup>37</sup>, nuk cenon nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

**23.3.11** Lidhur me verifikimin e ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm të interesit, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë<sup>38</sup> dhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>39</sup> nuk kanë konfirmuar çështje civile/penale, kërkesa civile etj. të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, ku palë të ketë qenë shoqëria “D.K” sh.p.k., apo administratori i saj, shtetasja K.B.

**24. Detyrim i pashlyer në vlerën 25.600 euro ndaj shoqërisë “L” sh.p.k.,** për pagesën e kështit të dytë, kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 30.7.2009, të noterit Y. Ç, për apartament banimi me adresën Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, me sipërfaqe të hipotekueshme 103,29 m<sup>2</sup>, me strukturë 2+1. Vlera e apartamentit: 82.600 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>40</sup>.

**24.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga shoqëria “L” sh.p.k.*

### **Hetimi i Komisionit**

**24.2** Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka likuiduar për këtë pasuri vlerën 58.455 euro, duke i mbetur pa shlyer edhe 24.145 euro.

**24.3** Subjektit i janë kërkuar<sup>41</sup> shpjegime lidhur me mosshlyerjen e detyrimit të mbetur. Në përgjigje të saj, subjekti ka sqaruar: *“...sipas parashikimit në kontratën e sipërmarrjes, kësti i fundit do të paguhej me marrjen në dorëzim të apartamentit. Duke mos qenë të vëmendshëm në*

<sup>37</sup> Nr. \*\*\*, datë 2.2.2023, Nr. \*\*\* Juridiksioni i rivlerësimit datë 16.2.2023.

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>39</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>40</sup> Kopje të ekstraktit të QKR-së për shoqërinë ndërtuese “L” sh.p.k., me NIPT \*\*\*. Aneks nr. 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 30.7.2009. Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>41</sup> Pyetësor nr. 2, datë 23.10.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

verifikimin e plotë të këtij parashikimi, dhe kryesisht nisur edhe nga fakti se pothuajse në kontrata të kësaj natyre kësti i fundit është parashikim i një garancie të vlerësuar nga palët kontraktore deri në hipotekimin e apartamentit, nuk i është kushtuar rëndësi këtij detaji. Pasi është kontaktuar me shoqërinë, kemi mësuar se kontrata ka qenë Tip, edhe vetë ata nuk i kanë kushtuar rëndësi këtij parashikimi dhe njëkohësisht na kanë pohuar të njëjtën argument se kësti i fundit ka qenë parashikim për t'u ekzekutuar me regjistrimin e pasurisë në hipotekë. Ndërkohë, nga shoqëria ndërtimore nuk na është kërkuar asnjëherë shlyerja e këtij detyrimi, pasi siç ju shpjegova qëllimi i shlyerjes nuk ka qenë me dorëzimin e pasurisë. Mendoj se nuk do të ishte as edhe e pranueshme që një pasuri të shlyhej plotësisht nëse për të nuk kishin përfunduar procedurat e regjistrimit. Në deklaratën noteriale nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.1.2024, shoqëria e ndërtimit "L" sh.p.k., nga ana e saj, në lidhje me këtë situatë, konfirmon faktin se kësti i fundit për këtë apartament ende nuk është paguar nga porositësi, z. I.D, në kushtet kur për këtë objekt pallat, i ndërtuar nga shoqëria "L" sh.p.k., sipas lejes së ndërtimit, miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.6.2006, të KRRT Bashkia Tiranë, ende nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit pranë ASHK-së Tiranë. Në referim të përcaktimeve të nenit 2 të kontratës, fitimi i pronësisë nga porositësi kushtëzohet, përveç kryerjes së pagesave të çmimit, edhe nga nënshkrimi i kontratës së bashkëpronësisë, pasi nga "L" sh.p.k. të jetë regjistruar objekti pranë ASHK-së (në atë kohë ZVRPP Tiranë). Sqarojmë se shoqëria "L" sh.p.k., në kushtet kur ende nuk është mundësuar regjistrimi i pallatit në ASHK, për shkak të problematikave që lidhen me pronarët e truallit mbi të cilin është ndërtuar ky objekt, ende nuk ka arkëtuar nga porositësi të ndryshëm të apartamenteve në këtë pallat këstin e fundit, i cili do të paguhet nga porositësit në momentin e regjistrimit dhe përpara lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes midis palëve..."). Subjekti ka deklaruar se deri aktualisht nuk është në ndonjë konflikt me shoqërinë për këtë mosshlyerje, apo në ndonjë objekt tjetër padie.

**24.4** Komisioni ka kërkuar informacion edhe nga shoqëria e ndërtimit "L" sh.p.k., e cila ka informuar<sup>42</sup> se nga kësti i fundit i papaguar prej 25.600 euro ka mbetur pa likuiduar vlera 24.145 euro.

**24.5** Për sa më sipër, rezultoi se dukej se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me detyrimin e mbetur dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me mospërputhjen e vërejtur paraprakisht midis vlerës së mbetur për të shlyer dhe asaj të deklaruar.

**24.6** Në qëndrimin e saj subjekti ka parashtruar se është një pasaktësi nga ana e saj, pasi, siç është referuar edhe nga shoqëria ndërtuese, por edhe nga dokumentacioni i depozituar nga ana e saj gjatë këtij procesi, ajo ka deklaruar shumë e këstit të fundit, sikurse ishte pasqyruar në kontratën e porosisë/sipërmarrjes, duke e cilësuar këtë fakt si të pandikueshëm në vlerën e vërtetë të detyrimit, e cila gjithsesi është në masën 24.145 euro. Sipas saj, kjo mospërputhshmëri mes gjendjes së faktit dhe deklarimit teorik të saj është një pasaktësi e dukshme e ardhur prej saj gjatë deklarimit, por në asnjë moment për të mbuluar apo devijuar të vërtetën.

**24.7** Trupi gjykues, për këtë çështje, vlerëson së kjo pasaktësi në deklarimin e subjektit lidhur me vlerën e detyrimit të mbetur, në raport me tërësinë e fakteve të dala nga hetimi dhe në mungesë të

---

<sup>42</sup> Me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 19.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

evidentimit të ndonjë të dhëne/indicieje ndryshe, nuk merr peshë në penalizimin e subjekti për këtë proces.

## **Deklarimi i nënës së bashkëshortit të subjektit – M.D**

**25. Pasuria apartament në emër të shtetas M.D**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 84 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier. Përfituar nga kontrata e shkëmbimit për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2016, të noteres A. D. Shitur me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2016. Me prokurën e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.11.2016, kaluar vlera nga shitja në llogarinë bankare në emër të shtetasit I.D në llogari rrjedhëse (në lek) në Credins Bank në ALL \*\*\* dhe llogari rrjedhëse (në euro) në Credins Bank në ALL \*\*\* (bashkëngjitur kontratë shkëmbimi, kontratë shitjeje). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>43</sup>.

**25.1 ILDKPKI-ja** në raportin e saj është shprehur: *Sa sipër, konstatohet se nëna e bashkëshortit të subjektit, M.D, në bashkëpronësi me nga ½ me motrën e saj A.P, kanë përfituar me dëshmi trashëgimie ligjore nga nëna e tyre Z.T truall në rrugën “\*\*\*\*”, të cilin ia kanë dhënë për ndërtim shoqërisë së ndërtimit “M-T” sh.p.k., nga ku kanë përfituar nga dy apartamente dhe një njësi secila. Një nga apartamentet, siç deklarohet, është shitur dhe M.D ka autorizuar me prokurë djalin e saj I.D për veprime me pasuritë e përcaktuara të saj (deklaruar nga I.D më lart). Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Fier.*

---

<sup>43</sup> Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 1.12.2016, me palë shitëse M.D dhe palë blerëse T.B, të apartamentit me sip. 84 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, në vlerën 4.400.000 lekë, shlyer shuma nëpërmjet llogarisë bankare ndërmjetëse të noteres F.Z, konkretisht shuma 20.000 euro, konvertuar në 2.700.000 lekë, si dhe shuma 1.700.000 lekë. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 7.7.2016, në emër të shtetas M.D, të pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, të apartamentit me sip. 84 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier; kartelë e pasurisë së paluajtshme, sipas së cilës në datën 23.11.2016 bëhet rivlerësimi i pasurisë me vlerë 4.454.920 lekë. Harta treguese, e regjistrimit. Njoftim debitimi datë 1.12.2016 nga Raiffeisen Bank, shtetasi T.B, në vlerën 20.000 euro, me përfitues “F.Z”, person fizik, me përshkrimin “Kalim shume për blerje shtëpie sipas kontratës nr. \*\*\*\*”. Njoftim debitimi datë 1.12.2016 nga Raiffeisen Bank, nga shtetasi T.B, në vlerën 1.700.000 lekë, me përfitues “F.Z”, person fizik, me përshkrimin “Kalim shume për blerje shtëpie sipas kontratës nr. \*\*\*\*”. Prokurë e posaçme pa afat nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, me të cilën shtetasja M.D autorizon djalin e saj I.D të administrojë, të tjetërsojë, të japë me qira etj., pasuritë në emër të saj me nr. \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier. Kopje ID-së. Kontratë shkëmbimi për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 24.6.2016, me palë të parë këmbyses M.D dhe A.P dhe palë të dytë këmbyses shoqëria “M-T” sh.p.k., me objekt “Shkëmbimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të tyre”. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 3.6.2016, në emër të firmës ndërtuese “M-T” sh.p.k., të apartamentit me sip. 100 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 19.7.2010, në emër të shoqërisë ndërtuese “M-T” sh.p.k., të apartamentit me sip. 84 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 3.6.2016, në emër të shoqërisë ndërtuese “M-T” sh.p.k., të njësisë me sip. 29 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 2.3.2007, në emër shtetaseve M.D dhe A.P, të truallit me sip. 340 m<sup>2</sup>, mbi të cilën ndodhet ndërtesa me sip. 45 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 3.6.2016, në emër të shoqërisë ndërtuese “M-T” sh.p.k., të apartamentit me sip. 100 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 3.6.2016, në emër të shoqërisë ndërtuese “M.T” sh.p.k., të apartamentit me sip. 100 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. Certifikatë për vërtetim pronësie datë 3.6.2016, në emër të shoqërisë ndërtuese “M-T” sh.p.k., të njësisë me sip. 30 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier. Kartelë e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. Aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së.

## Hetimi i Komisionit

**25.2** ZQRPP-ja<sup>44</sup> dhe ZVRPP Fier<sup>45</sup> kanë konfirmuar se në emër të shtetases M.D ka qenë e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, apartament me sip. 84 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri, me kontratën e shitjes datë 1.12.2016, ka kaluar në favor të personave të tretë, konkretisht shtetasit T.B. Për shitjen e kësaj pasurie, shtetasja M.D ka autorizuar djalin e saj I.D, duke lëshuar prokurën e posaçme pa afat nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, me të cilën autorizon djalin e saj të administrojë, tjetërsojë, të japë me qira etj., pasuritë në emër të saj me nr. \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier.

**25.3** Në dokumentacionin e ZVRPP-së rezultojnë të administruara kontrata e shitjes, prokura e posaçme, certifikata e pronësisë dhe kartela e pasurisë së paluajtshme në emër të shtetases M.D, si dhe kartela e pasurisë së paluajtshme në emër të shtetasit T.B.

### Lidhur me pasuritë e paluajtshme në pronësi të shtetases M.D

**25.4** Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP Fier rezulton se ajo ka pasur të regjistruar pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, lloji i pasurisë truall me sip. 340 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 45<sup>46</sup> m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi. Kjo pasuri është përfituar me dëshmi trashëgimie.

**25.5** Rezulton se me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.7.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për trashëgimlënësin S.T dhe Z.T. Këta të fundit janë prindërit e M.D (T) dhe A.P (T). Të dyja motrat kanë përfituar në pjesë të barabarta nga pasuria e prindërve të tyre.

**25.6** Pasuria nr. \*\*\* (truall + ndërtesë)<sup>47</sup> ka kaluar në emër të të tretëve me kontratë shkëmbimi në favor të shoqërisë ndërtuese “M-T” sh.p.k. Konkretisht, sipas kontratës së shkëmbimit për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 24.6.2016, me palë të parë këmbyses M.D dhe A.P, dhe palë të dytë këmbyses shoqëria “M-T” sh.p.k., me objekt “Shkëmbimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të tyre”, pala e parë ka në pronësi në pjesë të barabartë truall me sip. 340 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Fier, mbi të cilin ka qenë një ndërtesë me sip. 45 m<sup>2</sup>, e cila është prishur, pasi është bërë ndërtimi shumëkatësh nga shoqëria “M-T” sh.p.k. Shoqëria ndërtuese “M-T” sh.p.k. nga ndërtimi i objektit në këtë truall ka në pronësi një apartament me sip. 84 m<sup>2</sup>, tri apartamente me sip. 100 m<sup>2</sup> secili dhe dy njësi me sip. 30 m<sup>2</sup> dhe 29 m<sup>2</sup>. Këto pronësi palët i shkëmbejnë me njëra-tjetrën dhe pas shkëmbimit shoqëria njihet si pronare e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* (tokë truall).

- M.D njihet pronare e:

- apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- njësisë me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*.

<sup>44</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2017 (aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>45</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2017 (aneks nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>46</sup> Prona fillimisht ka qenë e regjistruar në emër të shtetases Z.T, sipas notës së transkriptimit në favor të saj, me nr. \*\*\* regjistri hipotekor, administruar në aneksin nr. 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>47</sup> Certifikatë për vërtetim pronësie datë 2.3.2007, në emër shtetaseve M.D dhe A.P, të truallit me sip. 340 m<sup>2</sup>, mbi të cilën ndodhet ndërtesa me sip. 45 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, regjistruar në ZVRPP Fier.



- A.P njihet pronare e:

- apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*;
- njësisë me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*.

**25.7** Për secilën nga pasuritë e cituara rezultojnë të administruara certifikatat e pronësisë dhe kartelat përkatëse, fillimisht në emër të shoqërisë ndërtuese “M-T” sh.p.k. dhe më pas në emër të shtetaseve M.D dhe A.P, sipas përshkrimit në kontratën e shkëmbimit.

- Komisioni nga hetimi i kryer për përfitimin e këtyre pasurive nuk konstatoi problematika, pasi u provua se ato janë përfituar nga trashëgimia ligjore dhe nga kontrata e shkëmbimit me shoqërinë ndërtuese.

**26. Pasuria apartament në emër të shtetases M.D, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 100 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier. Përfituar nga kontrata e shkëmbimit për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2016, të noteres A. D (bashkëngjitur certifikata për vërtetim pronësie). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>48</sup>.**

**26.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Fier.*

**26.2** Për këtë pasuri Komisioni i referohet të njëjtit hetim dhe konkluzion si më sipër evidentuar, faktet dhe përfundimet.

**27. Pasuria njësi shërbimi në emër të shtetases M.D, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 29 m<sup>2</sup>, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier. Përfituar nga kontrata e shkëmbimit për pasuri të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.6.2016, të noteres A. D (bashkëngjitur certifikata për vërtetim pronësie). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>49</sup>.**

**27.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga ZVRPP Fier. Pasuritë e regjistruara në pronësi të nënës së bashkëshortit të subjektit nuk kanë qenë objekt deklarimi në ILDKPKI në deklaratat e interesave privatë ndër vite, pasi referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, neni 7, kjo kategori nuk futet në rrethin e personave që kanë detyrimin për deklarim, pavarësisht se janë në të njëjtën përbërje familjare me subjektin. Gjithsesi, këto pasuri janë përfituar prej saj me dëshmi trashëgimie ligjore. Të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetases M.D janë në shumën 4.400.000 lekë.*

---

<sup>48</sup> Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 7.7.2016, në emër të shtetases M.D, të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, apartament me sip. 100 m<sup>2</sup>, me adresë lagjia “\*\*\*\*”, Fier. Harta treguese. Kartela e pasurisë së paluajtshme. Prokurë e posaçme pa afat nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, me të cilën shtetasja M.D autorizon djalin e saj I.D (aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>49</sup> Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 7.7.2016, në emër të shtetases M.D, të pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, njësi me sip. 29 m<sup>2</sup>, me adresë lagjia “\*\*\*\*”, Fier. Harta treguese. Kartela e pasurisë së paluajtshme. Prokurë e posaçme pa afat nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, me të cilën shtetasja M.D autorizon djalin e saj I.D (aneks nr. 4/12 në dosjen e ILDKPKI-së).

**27.2** Për këtë pasuri Komisioni i referohet të njëjtit hetim dhe konkluzion si më sipër, ndaj dhe nuk vlerëson të bjerë në përsëritje.

### **Deklarimi i djalit të subjektit – K.D**

**28. Llogari kartë *general* në Credins Bank në emër të shtetasit K.D, në lek, me gjendje në shumën 100.000 ALL.** Kredituar tërësisht nga shtetasi I.D (vërtetim nr. \*\*\* prot, datë 28.1.2017, vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017, *statement* i llogarisë kartë nga data 29.12.2016 deri më 24.1.2017). Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente<sup>50</sup>.

**28.1** ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur: *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.*

### **Hetimi i Komisionit**

**28.2** Credins Bank<sup>51</sup> informon se shtetasi K.D është klient pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë në datën 30.1.2017 është në vlerën 100.000 lekë. Nga analizimi i *statement*-it vihet re se në këtë llogari kreditimet kryhen nga shtetasi I.D. Konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.

### **Gjetje të tjera**

**29.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Lancia Thema” me targë \*\*\*, në vlerën 500.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat familjare.

**29.1** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti ka deklaruar se automjeti tip “Lancia”, deklaruar në vitin 2003, del jashtë qarkullimit në datën 30.12.2008.

**29.2** DPSHTRR-ja<sup>52</sup> ka depozituar dosjen e automjetit, nga ku rezulton se është blerë në vlerën 3.000 USD me kontratën e shitjes, ku palë shitëse është D.M dhe palë blerëse I.D, vërtetuar nga noteri publik me vërtetimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2000. Nga dokumentacioni i depozituar rezulton se mjeti ka dalë nga qarkullimi në datën 30.12.2008.

**29.3** Komisioni kreu analizën financiare duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuara për periudhën 1997 – qershor 2000, ku pas përlllogaritjeve konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj kanë pasur mundësi të investojnë në blerjen e automjetit, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare.

**30.** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, djali i subjektit, shtetasi K.D, ka deklaruar: *“Në llogarinë time pranë BKT-së është kredituar vlera 8.000 euro, në datën 5.1.2016, për efekt të marrjes së vizës në Ambasadën Gjermane, me burim nga*

---

<sup>50</sup> Konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2017, nga Credins Bank, në emër të shtetasit K.D, i cili ka llogari kartë *general purpose* në monedhën lek, me gjendje në vlerën 100.000 lekë; nxjerrje llogari bankare për periudhën 29.12.2016 – 28.1.2017 në Credins Bank, në emër të shtetasit K.D, me gjendje të mbetur në datën 28.1.2017, vlerën 100.000 lekë (referuar transaksioneve rezultojnë gjatë kësaj periudhe kreditime nga I.D dhe debitime nga djali i subjektit); konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017, nga Credins Bank, në emër të shtetasit K.D, i cili ka llogari kartë *general*, me gjendje në vlerën 100.000 lekë. Aneks nr. 4/16 në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>51</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>52</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

*llogaria personale e shtetasit A.B. Kjo vlerë i është rikthyer përsëri në të njëjtën llogari shtetasit A.B, në datën 16.2.2016. Në llogarinë time në BKT është kredituar vlera prej 8.800 euro nga llogaria personale e A.B në datat 22.8.2016 dhe 9.9.2016 , për efekt të marrjes së vizës gjermane. Kjo vlerë është rikthyer përsëri në të njëjtën llogari rrjedhëse A.B, në datën 13.10.2016”.*

**30.1** Nga korrespondenca e Komisionit me BKT-në<sup>53</sup> rezultoi se shtetasi K.D/djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur llogari pranë kësaj banke. Nga verifikimi i *statement*-it rezulton se në llogarinë e tij janë kryer transaksionet sipas deklaramit të tij. Konkretisht:

- është kredituar në datën 5.1.2016 shuma 8.000 euro nga shtetasi A.B – këtij të fundit kjo shumë i është kthyer në datën 16.2.2016;
- është kredituar në datën 22.8.2016 shuma 8.000 euro nga shtetasi A.B;
- është kredituar në datën 9.9.2016 shuma 800 euro nga shtetasi A.B;
- shtetasit A.B i është kthyer shuma 8.797 euro, në datën 13.10.2016.

**30.2** Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e krijimit të shumave të kaluara nga llogaria e shtetasit A.B në llogarinë e djalit të saj. Në përgjigje të saj, subjekti ka depozituar llogarinë bankare të shtetasit A.B dhe shoqërisë “L” sh.p.k.

**30.3** Nga analizimi i llogarive vihet re se:

**i.** Shtetasit A.B në datën 5.1.2016 i kreditohet në llogarinë e tij personale në monedhën euro, në BKT, shuma 8.000 euro nga shoqëria “L” sh.p.k. Po në këtë datë, këtë shumë ia ka transferuar shtetasit K.D, djali i subjektit.

**ii.** Shtetasi A.B ka tërhequr nga llogaria e shoqërisë “L” sh.p.k., në datën 22.8.2016, shumën 8.500 euro dhe po në këtë datë ka depozituar në llogarinë e tij personale shumën 8.000 euro. Më pas, po në datën 22.8.2016, shumën 8.000 euro e ka transferuar nga llogaria e tij personale në llogarinë e shtetasit K.D.

**iii.** Shtetasi B depoziton në llogarinë e tij personale shumën 800 euro në datën 9.9.2016 dhe në po në këtë datë, pas depozitimit, e transferon në llogarinë e shtetasit K.D.

**30.4** Gjatë hetimit, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëshoqërues të pyetësorit nr. 1, u vërejt se subjekti ka depozituar pasaportën e djalit të saj, nga ku rezulton se ai ka marrë vizat gjermane me afatet (datë lëshimi dhe skadimi) 19.2.2016 – 18.5.2016 dhe 12.10.2016 – 11.4.2017. U vërejt se datat kur janë lëshuar vizat korrespondojnë me transaksionet bankare, të cilat janë kryer përpara marrjes së vizës.

**30.5** Për sa më sipër, Komisioni, duke konstatuar se: (i) burimi i fondeve vjen nga shoqëria “L” sh.p.k., ku shtetasi B është ortak i vetëm dhe administrator; (ii) këto shuma nuk janë përdorur, transferuar apo tjetërsuar prej djalit të subjektit, por kanë qëndruar në llogari dhe më pas i janë rikthyer përsëri shtetasit B – nuk konstaton problematika lidhur me këtë çështje.

**Lidhur me mbiemrat e mbajtur nga subjekti**

---

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

**31.** Komisioni, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë pasur edhe mbiemrin Sejдини, në kërkimin e tij përfshiu edhe këtë mbiemër, dhe nga hetimi nuk i rezultoi ndonjë e dhënë/*indicie* tjetër në ekzistencën e ndonjë pasurie, apo të dhëna të tjera të lidhura me kriteret e tjera të rivlerësimit, përveç sa është konfirmuar, hetuar dhe arsyetuar në këtë vendim.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**32.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2023, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

### **Hetimi i Komisionit**

**32.1** Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

**32.2** Në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e plotësisht të deklaratës për kontrollin e kriterit të figurës (sipas shtojcës 3), nga verifikimi përkatës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka pasur përveç mbiemrit Deçolli edhe mbiemrat V dhe S. Në tërësi, duket se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi këtë deklaratë.

**32.3** Në lidhje me këtë deklaram, Komisioni mbajti korrespondencë me institucionet publike dhe nga hetimi i kryer nuk rezultoi ndonjë e dhënë në drejtim të ekzistencës së ndonjë pasurie të luajtshme e të paluajtshme në emër e për llogari të subjektit me mbiemrat e tjerë.

**32.4** Në vijim të hetimit lidhur me kontrollin e figurës, pas kërkesës së Komisionit<sup>54</sup> për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2024, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 20.2.2024. Raporti ka konfirmuar se veprimtaria e dyshuar i përket periudhës përpara datës 1.1.2012, një periudhë shumë e hershme kohore, dhe nuk ka tregues apo të dhëna që të evidentojnë faktin që ajo të vazhdojë, ndaj sipas raportit ky fakt mund të konsiderohet rrethanë lehtësuese sipas përcaktimeve dhe kriterëve të përcaktuara në shkronjën “d” të pikës 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, ky autoritet në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmërinë në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Fatime S. Deçolli ka gjykuar që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj

---

<sup>54</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, AKSIK-ja ka informuar se nga informacionet e përditësuara, në vitet 2023 e 2024, nga ana e autoriteteve verifikuese, pas vitit 2008 dhe deri aktualisht, nuk rezultojnë të dhëna të reja lidhur me kriterin e kontrollit të figurës së subjektit në fjalë.

**32.5** Komisioni, për të konkluduar në lidhje me informacionin dhe të dhënat e paraqitura nga AKSIK-ja në raportin e lartpërmendur, ka kërkuar informacione dhe të dhëna në disa drejtime.

**32.6** Komisioni administroi<sup>55</sup>:

**32.6.1** Kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 21.12.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

**a.** Nga verifikimi i këtij vendimi<sup>56</sup> rezultoi se çështja gjyqësore ka pasur si objekt gjykimi zgjidhjen e martesës mes dy bashkëshortëve, çështje e shqyrtuar dhe e përfunduar nga një tjetër subjekt. Nga verifikimi përkatës rezultoi se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

**32.6.2** Kopje të praktikës së përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>57</sup>, nga ku rezultoi se me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 28.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është vendosur nga subjekti i rivlerësimit korrigjimi i aktit të certifikatës së lindjes së një shtetasi<sup>58</sup>.

**a.** Lidhur me këtë çështje gjyqësore të vitit 2002, Komisioni nuk konstatoi fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e procesit për këtë subjekt dhe as nuk krijuan bindjen për ndonjë dyshim të mundshëm në gjykim për të implikuar subjektin në cenimin e kriterit të figurës.

**b.** Në vijim të hetimit për dyshimet e ngritura, Komisioni verifikoi të dhënat gjyqësore mbi disa shtetas, për të cilët: (i) Zyra e Gjendjes Gjyqësore<sup>59</sup> nuk konfirmoi dënime të dhëna nga gjykata penale shqiptare, si dhe<sup>60</sup> provoi informacionin me vërtetimet e gjendjes gjyqësore, nga ku rezultoi se shtetasit e verifikuar ishin të padënuar; (ii) Ministria e Drejtësisë konfirmoi se për këta shtetas nuk rezulton të ketë praktika hyrëse apo komunikim me autoritetet italiane të drejtësisë; (iii) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>61</sup> nuk konfirmoi kallëzime, procedime penale apo kërkesë për njohje të vendimeve të huaja ndaj këtyre shtetasve; (iv) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>62</sup> nuk konfirmoi dënime penale të dhëna ndaj këtyre shtetasve brenda apo jashtë vendit; (v) SPAK-u<sup>63</sup> nuk konfirmoi materiale kallëzuese apo procedim penal të regjistruar në ngarkim të këtyre shtetasve.

---

<sup>55</sup> Administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në dosjen e Komisionit.

<sup>56</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.7.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>57</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>58</sup> Vendimi ka pasur si palë ndërgjyqëse Institucionin e Sigurimeve Shoqërore, si dhe Zyrën e Gjendjes Civile. Nga verifikimi i vendimit rezultoi se kërkesa është depozituar sipas nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Vendimi ka konkluduar në korrigjimin e përbërësve të Gjendjes Civile të këtij shtetasi bazuar në aktet e përcjella nga institucionet përkatëse të pasqyruara dhe të arsyetuara në vendimin e subjektit. Konstatohet se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

<sup>59</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>60</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>61</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>62</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>63</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

**32.6.3** Në lidhje me informacionin se institucionet verifikuese e kishin përmendur subjektin e rivlerësimit edhe në një informacion që i ishte përcjellë Presidentit të Republikës, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Drejtësisë, në vitin 2008, Komisioni mbajti korrespondencë me këto institucione, duke u fokusuar tek ndikimi i subjektit në procesin e ekzekutimit të vendimeve penale (lidhur me vonesa të mundshme) në kohën që ajo kishte mbajtur detyrën e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Berat.

**32.6.4** Mbi ekzistencën e këtij informacioni, nga hetimi i kryer, institucioni i Presidentit<sup>64</sup> dhe Ministria e Drejtësisë<sup>65</sup> nuk konfirmuan të dhëna lidhur me këtë çështje.

**32.6.5** Mbi të dhënën e Prokurorisë së Përgjithshme<sup>66</sup>, informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat<sup>67</sup> nuk konfirmoi ndonjë procedim penal të regjistruar, hetuar, mosfilluar, pushuar apo pezulluar në ngarkim të këtij shtetasi.

**32.6.6** Komisioni hetoi mbi dënime të dhëna ndaj shtetasit S.D, si dhe mbi procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhënë ndaj këtij shtetasi. Komisioni, pasi administroi gjendjen gjyqësore<sup>68</sup> të tij, konstatoi se ai ishte dënuar nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 29.5.2007, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” me 6 muaj burgim dhe sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore ishte rehabilituar bazuar në nenin 69 të Kodit Penal.

**32.6.7** Mbi këtë konfirmim, Komisioni administroi praktikën e plotë gjyqësore<sup>69</sup>, përfshirë edhe atë të ekzekutimit të vendimit dhënë ndaj këtij shtetasi<sup>70</sup>. Nga të dhënat e hetuara rezultoi se shtetasi S.D ishte gjykuar në gjendje të lirë, për të çështja ishte pushuar në shkallë të parë dhe, më tej, Apeli kishte ndryshuar vendimin duke e dënuar me 6 muaj burgim, por ky vendim ishte

---

<sup>64</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2023, nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>65</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2023, nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>66</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.2.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>67</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>68</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 28.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>69</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.9.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>70</sup> Nga aktet e administruara rezultoi: (i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat (e përbërë nga një tjetër subjekt rivlerësimi) me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2006, kishte vendosur ndaj të pandehurit S.D, akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, “*Pushimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të tij*”, pasi vepra nuk duhej të fillonte; (ii) Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2007, kishte vendosur ndryshimin e vendimit për këtë të pandehur, duke e gjykuar çështjen në fakt dhe në këtë mënyrë kishte deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale të lartpërmendur; (iii) Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 19.6.2007, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, ishte urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit nr. \*\*\*, (iv) Në datën 25.2.2008, prokurori T. P. kishte urdhëruar vënien në ekzekutim të vendimit penal nr. \*\*\* të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili sipas këtij urdhri kishte marrë formë të prerë më 29.5.2007. Në arsyetimin e urdhrin të prokurorit, ndër të tjera, konfirmohet se ky shtetas është gjykuar në gjendje të lirë; (v) Në datën 28.2.2008, nga OPGJ-ja në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat është mbajtur procesverbali për ekzekutimin e vendimit penal nr. \*\*\* të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe urdhri i ekzekutimit të datës 25.2.2008, të prokurorit T.P, për këtë të dënuar. Në procesverbal thuhet se shtetasi D. është gjendur në banesën e tij dhe është treguar i gatshëm për ekzekutimin e vendimit në dhomat e paraburgimit. Po në këtë datë është mbajtur edhe procesverbali për kontrollin e tij personal; (vi) Me vendimin datë 13.3.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat<sup>70</sup> (sipas vendimit gjyqësor, çështja është regjistruar në datën 4.1.2008) ka vendosur ndaj kërkuesit S.D “*Rrëzimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit penal nr. \*\*\*, datë 29.5.2006, të Gjykatës së Apelit Vlorë*”; (viii) Me urdhrin e transferimit datë 18.3.2008, ky shtetas është transferuar nga paraburgimi në burg.

rekursuar prej tij dhe deri në përfundim të gjykimit nga Gjykata e Lartë ishte vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit penal. Më tej, pas mospranimit të rekursit rezultoi se nga organi i akuzës<sup>71</sup> ishin ndjekur në kohë procedurat për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**32.6.8** Për sa më sipër, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk kishte gjykuar ndonjë prej çështjeve gjyqësore me këtë shtetas dhe gjithashtu nuk u identifikua ndonjë vonesë apo shkak vonese në ekzekutimin e vendimit, e ndikuar nga roli apo pozita e subjektit.

**32.6.9** Po në lidhje me pozitën e subjektit të rivlerësimit (si drejtuese e institucionit) në ekzekutimin e vendimeve penale, në raport me ligjin e zbatueshëm të kohës, Komisioni iu referua legjislacionit të aplikueshëm<sup>72</sup>. Në interpretim të tij, duket se për shkak të natyrës që vetë ekzekutimi i vendimit ka, por edhe në raport me legjislacionin e kohës, roli i drejtuesit të gjykatës nuk përfshihej në këtë proces. Pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni për të shteruar hetimin për çdo *indicie* të mundshme, për të riqartësuar pozitën e saj si drejtuese institucioni në atë kohë, për procedurën e tematikës së trajtuar më sipër, i kërkoi shpjegime subjektit<sup>73</sup> lidhur me: (i) praktikën e ndjekur nga institucioni që drejtonte në atë kohë, në raport me legjislacionin e kohës, sa i përket

---

<sup>71</sup> Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, neni 9/Prokurori/Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente ose të paraqesë kërkesë në gjykatë për rivendosjen e ligjit e të së drejtës së shkelur dhe vënien e shkakuarëve para përgjegjësisë sipas ligjit. Neni 12/Prokurori/Prokurori është organi që vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të të gjitha vendimeve të tjera penale dhe në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit sipas Kodit të Procedurës Penale, sipas këtij ligji dhe dispozitave të tjera ligjore. Prokurori mban evidencë të veçantë për vendimet në ekzekutim dhe për të gjitha faktet e ndodhura gjatë ekzekutimit. Neni 13/Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit, si dhe prokurorët që kanë marrë pjesë në gjykim pranë Gjykatës së Apelit apo Gjykatës së Lartë, menjëherë pas administrimit, i paraqesin zyrtarisht dispozitivin e vendimit penal prokurorisë përkatëse të shkallës së parë që ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit. Urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit...

<sup>72</sup> Neni 13 i ligjit nr. 8331/1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit, si dhe prokurorët që kanë marrë pjesë në gjykim pranë Gjykatës së Apelit apo Gjykatës së Lartë, menjëherë pas administrimit i paraqesin zyrtarisht dispozitivin e vendimit penal prokurorisë përkatëse të shkallës së parë që ka përgjegjësinë e ekzekutimit të vendimit. Urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit...

- Neni 386 i Kodit të Procedurës Civile/Depozitimi i vendimit/Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas arsyetimit, brenda afateve të parashikuara në nenin 382 të këtij Kodi. Nën punësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit. 2. Vendimi u njoftohet palëve që nuk kanë qenë të pranishme në shpalljen e tij në adresën e deklaruar prej tyre. - Ligji nr. 8331/2008, neni 48/Afatet e veprimeve të gjykatës/Veprimet për vënien në ekzekutim të vendimit penal duhet të kryhen menjëherë, sapa të jenë plotësuar kushtet ligjore, por jo më vonë se brenda këtyre afateve: 1. Për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe që nuk janë ankuar ose nuk është ushtruar rekurs, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë. 2. Për vendimet që përmbajnë dënime me burgim, për të cilin është ushtruar ankim ose rekurs, vendimi i dërgohet prokurorit për çështjet, me të arrestuar, brenda 24 orëve nga data e ardhjes nga gjykata përkatëse dhe brenda 48 orëve për të tjerat. 3. Vendimet që përmbajnë dënime penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jo më vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë. 4. Kur është vendosur pezullimi ose shtyrja e ekzekutimit të vendimit, afatet e mësipërme fillojnë nga data që gjykata anulon pezullimin ose plotësohet afati i shtyrjes.

- Ligji nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 38/Kompetencat e kancelarit/(shfuqizuar shkronja “a” me vendim të Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 9.7.2009)/Kancelari i Gjykatës ka këto kompetenca kryesore: ...c) ndjek ecurinë e dorëzimit të dosjeve gjyqësore të përfunduara në sekretarinë gjyqësore, në përputhje me afatet procedurale të parashikuara në ligj; Neni 18/Kompetencat e Kryetarit të Gjykatës ...3. Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetari i Gjykatës së Apelit, përveç sa më sipër, kryejnë edhe këto detyra: a) përfaqësojnë gjykatën në marrëdhëniet me të tretët...

<sup>73</sup> Me pyetësin nr. 5, datë 19.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

ekzekutimit të vendimeve penale; (ii) rolin e saj si drejtuese e institucionit në këtë proces; dhe nëse (iii) kishte pasur ndonjë rregullim të brendshëm me qëllim ndjekjen e ekzekutimit të vendimeve penale në kohë e, nëse po, i kërkoi t'i depozitojë ato.

**32.6.10** Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka shpjeguar duke referuar gjerësisht edhe legjislacionin mbështetës (parashikimet e neneve 463<sup>74</sup> dhe 464<sup>75</sup> të Kodit të Procedurës Penale etj., si dhe nenet 12 dhe 13<sup>76</sup> të ligjit nr. 8331/1998) dhe ka konfirmuar se: (i) ekzekutimi i vendimeve penale ka qenë dhe është një veprimtari sa procedurale aq edhe administrative, ku ndërthuren rolet dhe kompetencat e administratës gjyqësore, e cila në këtë lloj veprimtarie realizon si procesin administrativ po ashtu edhe atë procedural ligjor; (ii) në këtë lloj veprimtarie roli i gjykatës në ekzekutimin e vendimeve penale, si ai administrativ ashtu edhe ai procedural, është dytësor, duke qenë se ligji penal parashikon prokurorin si subjektin i cili kryen ekzekutimin e vendimeve penale.

**32.6.11** Subjekti ka sqaruar se përveçse detyrimi i zbatimit dhe ekzekutimit të vendimeve penale është rregulluar nga ligji procedural penal, në konformitet me këto përcaktime bazë janë përpiluar dhe zbatuar urdhra dhe udhëzime më specifike nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për administratën gjyqësore<sup>77</sup>, me qëllim kontrollin sa më të hollësishëm të këtyre detyrimeve procedurale, të kryera nga kjo administratë. Subjekti ka shpjeguar hollësisht gjithë procesin e ekzekutimit të vendimeve, duke cilësuar rolin dhe detyrën që kishte secila hallkë, prej gjyqtarit të çështjes, sekretares gjyqësore, regjistrimit të çështjes në regjistrat përkatës, rolit të kryesekretarisë gjyqësore, mënyrën e komunikimit/njoftimit të akteve, rolin e përfaqësuesit të organit të akuzës etj., duke kundërshtuar

---

<sup>74</sup> Neni 463 i Kodit të Procedurës Penale “Veprimet e prokurorit”, parashikon se: “1. Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyr në të gjitha veprimet e ekzekutimit. 2. Vendimet e prokurorit i njoftohen brenda tridhjetë ditëve mbrojtësit të caktuar nga i interesuari ose, kur nuk ka të tillë, atij të caktuar nga prokurori. 3. Kur është e nevojshme, prokurori mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të veçanta nga prokurori i një rrethi tjetër. 4. Kur fillon ekzekutimi, prokurori njofton me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin”.

<sup>75</sup> Neni 464 i Kodit të Procedurës Penale “Ekzekutimi i vendimeve me burgim”, parashikon se: “1. Për ekzekutimin e një vendimi me burgim, prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit. 2. Urdhri i ekzekutimit përmban gjeneralitetet e të dënuarit, dispozitivin e vendimit dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin. 3. Kur i dënuari është i paraburgosur, urdhri i dërgohet organit shtetëror që administron burgjet dhe i njoftohet të interesuarit, ndërsa kur i dënuari nuk është i paraburgosur urdhërohet burgimi i tij. 4. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastet e ekzekutimit të vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione mjekësore ose edukimi”.

<sup>76</sup> Nenet 12 e 13 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Neni 12/Prokurori/Prokurori është organi që vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të të gjithë vendimeve të tjera penale dhe në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit sipas Kodit të Procedurës Penale, sipas këtij ligji dhe dispozitave të tjera ligjore. Prokurori mban evidencë të veçantë për vendimet në ekzekutim dhe për të gjitha faktet e ndodhura gjatë ekzekutimit. Neni 13/Urdhri i ekzekutimit/Urdhri i ekzekutimit është akti proceduralor mbi bazën e të cilit prokurori nis procedurën e ekzekutimit të vendimit penal. Urdhri i ekzekutimit përmban vendimin penal që vihet në ekzekutim, identitetin e të dënuarit, vendndodhjen e tij, llojin dhe masën e dënimit kryesor që do të vuhet efektivisht, llojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij, detyrimin civil në procesin penal, si dhe organet që do të ekzekutojnë ose mbikëqyrin ekzekutimin e vendimit.

<sup>77</sup> Subjekti ka theksuar se në kohën për të cilën kërkohen shpjegime, në gjykatë është zbatuar rregullorja e Ministrisë së Drejtësisë nr. 1830, datë 3.4.2001. Rregullorja vjen konform ligjit procedural civil dhe penal të kohës. Subjekti ka depozituar pjesë të rregullores së Ministrisë së Drejtësisë. Rregullorja ka parasysh parashikimet e neneve 386, 413, 410 e 462 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat së bashku lidhin organikisht detyrimet e administratës gjyqësore me detyrat e prokurorit, për sa i përket ekzekutimeve penale.



dhe përjashtuar në këtë mënyrë pozitën apo ndikimin e saj si drejtuese, në këtë proces, si tek gjyqtari apo tek administrata gjyqësore.

**32.6.12** Në lidhje me ndonjë rregullim të brendshëm që mund të ketë pasur gjykata me qëllim ndjekjen e ekzekutimit të vendimeve penale në kohë, subjekti është shprehur se në dijeninë e saj përveç Kodit të Procedurës Penale, rregullores së Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2001, librave të mbajtur sipas kërkesave që parashikonte kjo rregullore (të cilët për vitet 2000 – 2008 janë të arkivuar në atë gjykatë), nuk ka pasur ndonjë rregullim tjetër. Subjekti ka konfirmuar se nuk ka rezultuar ndonjë problematikë apo specifike e cila të nxirrte të nevojshme një rregullim tjetër përtej atij që ishte dhe zbatohet tashmë. Ajo ka depozituar pjesë nga rregullorja e Ministrisë së Drejtësisë e vitit 2001, për administratën gjyqësore, ku pasqyrohen rregullimet ligjore për këtë të fundit.

**32.6.13** Trupi gjykues, në analizë të fakteve e rrethanave të pasqyruara më sipër, dokumentacionit të administruar, shpjegimeve e dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, në raport me legjislacionin përkatës të kohës, konstatoi se dyshimet e ngritura për secilën çështje apo tematikë të trajtuar mbetën të paprovuara, pa ndonjë tregues dyshues që implikonte subjektin në ndonjë çështje të gjykuar, pa rol/eksponim në ekzekutimin e vendimeve penale.

**32.6.14** Lidhur me këtë kriter, në rrethanat e kësaj çështjeje objekt vlerësimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se dyshimet e ngritura nuk ishin të mbështetura në të dhëna të sakta dhe nga hetimi i Komisionit ato nuk u gjendën të bazuara në fakte apo prova që mund të provonin çdo dyshim të arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës që mund të passillnin cenimin e pastërtisë së figurës. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi i tij<sup>78</sup> nuk evidentoi ndonjë *indicie* apo fakt tjetër që mund të mbështeste këto dyshime dhe, si rrjedhojë e këtij vlerësimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**33.** Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, sa i përket tri dokumenteve<sup>79</sup> të vëna në dispozicion nga subjekti nuk konstatoi problematika.

---

<sup>78</sup> AKSIK-ja ka informuar se nga informacionet e përditësuara, në vitet 2023 e 2024, nga ana e autoriteteve verifikuese, pas vitit 2008 dhe deri aktualisht, nuk rezultojnë të dhëna të reja lidhur me kriterin e kontrollit të figurës së subjektit në fjalë.

<sup>79</sup> 1. Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 14.11.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit S. L, me të paditur shoqëria “A” sh.a., me objekt “Pavlefshmëri e zgjidhjes së kontratës së punës dhe detyrimi për dëmshpërblim...” 2. Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 27.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit N. J, me të paditur Bashkia \*\*\* dhe Ministria e \*\*\*, me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, me objekt “Detyrimin për shpërblim për shtëpinë e banimit...”. 3. Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që u përket paditëseve N. S, I. K, E. M e D. S, me të paditur H. M, person i tretë Bashkia \*\*\*, IKMT \*\*\* e Ministria e \*\*\*, me objekt “Detyrimin për pushimin e cenimit të pronësisë etj.”. Këto akte janë ridepozituar nga subjekti pas kërimit të Komisionit me *email*-in datë 18.3.2024, me ekstremitetet e duhura, konkretisht të nënshkruara nga subjekti dhe sekretarja gjyqësore, si dhe të vulosura nga institucioni përkatës.

**33.1** Në lidhje me pesë dosjet<sup>80</sup> e shortuara nëpërmjet një sistemi rastësor, për të cilat është konkluduar në raportin e KLGJ-së, Komisioni nga verifikimi përkatës, ashtu sikurse ka konkluduar edhe raporti i këtij të fundit, konstatoi se: (a) Në tri raste ankimimi, vendimet janë lënë në fuqi (përkatësisht në dosjet 1, 2 e 4); (b) Vendimi që i përket dosjes nr. 3, me palë ndërgjyqëse: paditëse L.M, kundër të paditurve P. M, I. L e N. L, person i tretë ZVRPP Tiranë, me objekt gjykimi “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. \*\*\*, datë 12.6.1992...”, është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke e kthyer çështjen për rigjykim. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezultoi se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 23.10.2014, është prishur nën arsyetimin se duhej realizuar një proces i rregullt ligjor me qëllim që paditësja të kishte akses të plotë në dosje dhe se padia nuk duhej trajtuar si një padi pa shkak në objektin e saj (që padia të merret në shqyrtim duhet të përmbajë jo vetëm kërkimin që përbën objektin e saj, por edhe shkakun e objektit), sikurse kishte trajtuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, porse ajo mund të ishte kthyer për të ndrequr të metat e konstatuara të padisë (nëse padia vlerësohej si pa objekt pa shkak).

**33.2** Për sa më sipër, Komisioni<sup>81</sup> i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit të Gjykatës së Apelit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**33.3** Në shpjegimet e saj lidhur me këtë çështje gjyqësore, subjekti ka sqaruar se pavarësisht konstatimit të Gjykatës së Apelit, e cila kishte arsyetuar se padia mund të ishte kthyer nga gjykata e shkallës së parë për të ndrequr të metat e konstatuara të saj (nëse padia vlerësohej si pa objekt pa shkak), por jo të rrëzohej, kjo gjykatë nuk e ka gjykuar çështjen në fakt, por e ka kthyer atë për rigjykim.

**33.4** Subjekti ka theksuar se arsyetimin e vendimit e ka mbështetur kryesisht në vendimin unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili trajton gjerësisht dhe unifikon problematikat procedurale dhe ligjore të padive, ku kërkim kryesor është pavlefshmëria e veprimeve juridike, sikurse është padia në fjalë. Subjekti ka argumentuar se vendimmarrja e saj mbështetet në pikat 21, 21.1, 21.22, 39.2 dhe 40.1<sup>82</sup> të vendimit unifikues. Ajo ka konfirmuar se

---

<sup>80</sup> Dosja 1 – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 10.7.2013, që i përket paditësit G. H, kundër të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 11.4.2013, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për dhënien e masës disiplinore, vendimit nr. \*\*\*, datë 6.6.2013 etj...”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.10.2013. Dosja 2 – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 19.11.2012, që i përket paditëses V. D, kundër të paditurit DRSSH Tiranë, me objekt “Pavërtetësi dokumenti, regjistrit themeltar për sa i përket emrit të atësisë së shkruar...”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.10.2013. Dosja 3 – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 3.4.2014, që i përket paditëses L. M, kundër të paditurve P. M, I. L e N. L, person i tretë ZVRPP Tiranë, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së dhurimit nr. \*\*\*, datë 12.6.1992. Zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë. Njohjen pronarë në pjesën ideale etj.”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.10.2014. Dosja 4 – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 16.10.2014, që i përket paditësit K. N, me të paditur \*\*\* sh.a., me objekt “Detyrimin për dëmshpërblim nga zgjidhja e pajustificuar e kontratës së punës”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.12.2014. Dosja 5 – Çështja administrativo-penale nr. \*\*\* regj., datë 3.2.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Vleftësimin të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, kundër të dyshuarës M. J”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2016.

<sup>81</sup> Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>82</sup> “Vetëm kërkimi i konstatimit të pavlefshmërisë së një veprimi juridik, i cili në kuptim të ligjit nuk ka prodhuar asnjë pasojë juridike, pa treguar shkakun e këtij kërkimi dhe pasojat që ai mund të ketë sjellë, nuk mund të merret në

ka arritur në konkluzionin se padia është pa objekt dhe duhet rrëzuar, pasi ka analizuar provat shkresore, parashtrimet dhe prapësimet e palëve në gjykim.

**33.5** Padia referuar fakteve dhe provave të administruara dhe të debatuar në fazën e shqyrtimit gjyqësor nuk përmbante shkakun ligjor të saj, kërkimin konkret, në lidhje me kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, pra e drejta dhe gjendja e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte. Sipas parashtrimeve dhe pohimit të paditëses nëpërmjet avokates së saj, statusi aktual i pasurisë rezultonte të ishte në favor vetëm të të paditurit P.M (bashkëshorti i paditëses ) dhe jo në bashkëpronësi të të tre të paditurve (shihni shkresën e ZVRPP-së Tiranë nr. \*\*\*, datë 27.2.2014, f. 26 e dosjes gjyqësore). Kjo sepse, sikurse pohonte paditësja, mbi pronën ishin bërë transaksione. Ky fakt ka rezultuar në provat e paraqitura nga paditësja.

**33.6** Subjekti ka konfirmuar se në seancën gjyqësore të datës 23.9.2014, gjykata ka pyetur paditësen në lidhje me statusin aktual të pronës, duke qenë se ky sqarim ishte i rëndësishëm për zgjidhjen e pasojave të veprimit juridik të paligjshëm. Qëllimi i padisë ishte rivendosja e bashkëpronësisë së paditëses L.M me të paditurit P.M, kur ndërkaq nga aktet e ish-ZVRPP-së Tiranë pasuria figuronte në favor vetëm të shtetasit P.M. Pra, me pak fjalë, në gjykim u provua se pas veprimit juridik objekt gjykimi, mbi pronën ishin bërë transaksione të tjera, të cilat e kishin ndryshuar statusin e saj të pronësisë, i cili nuk rezultonte të ishte më tre bashkëpronarët e paditur, të cilëve i kundrejtohej padia. Nga ana tjetër, vërtetohej se statusi aktual i pronës ishte ai *de facto* sipas kërkimit të padisë, pra në favor vetëm të shtetasit P.M. Po i pyetur nga gjykata në seancën gjyqësore, avokatja e paditëses ka pohuar se pasuria posedohej nga ky i paditur, shtetasi P.M. Në këto rrethana, subjekti është shprehur se pasi ka konstatuar se kërkimi i padisë i bazuar në nenin

---

*shqyrtim nga gjykata. 21. Gjkata, si për çdo gjykim tjetër civil, edhe në rastin e gjykimit të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, nuk mund të dalë jashtë kornizës ligjore të parashikuar nga nenet 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile. 21.1. Në këtë dispozitë është parashikuar se “Gjkata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet” (neni 6) dhe se “Gjkata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj...” (neni 28). 21.2. Nëse gjykata zgjidh pasojat juridike të një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm, pa kërkesë të palës ose tej asaj që pala ka kërkuar, nuk bën gjë tjetër veçse zëvendëson padinë e paraqitur me një padi të ndryshme, duke shkelur parimin procedural të përputhjes ndërmjet kërkesës së bërë nga palët dhe asaj që gjykata duhet të vendosë (nenet 6 dhe 28 të Kodit të Procedurës Civile). 22. Një ndër elementet që identifikon padinë dhe pa të cilin nuk mund të ketë padi është shkaku i saj (causa petitionis). Shkaku i padisë është arsyeja e kërkimit gjyqësor që përbëhet nga e drejta dhe nga një gjendje fakti që i kundërvihet kësaj të drejte. Që padia të merret në shqyrtim nga gjykata duhet të përmbajë në vetvete jo vetëm kërkimin që përbën objektin e saj, por dhe shkakun... Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë pa treguar të drejtën dhe gjendjen e faktit që i është kundërvënë kësaj të drejte është një padi që në kuptim material nuk ekziston. Nuk ka padi pa shkak... derisa në një gjykim nuk kërkohet, të paktën zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë, gjykata nuk mund të shprehet në lidhje me pasojat e ardhura nga ekzekutimi i këtij veprimi juridik. Nëse gjykata kryesisht, ex officio, konstaton pavlefshmërinë e një veprimi juridik dhe zgjidh pasojat e pavlefshmërisë, duke i kthyer palët në të quajturën gjendje të mëparshme (restitutio in integrum) pa kërkesë të palës/palëve, ajo shkel parimin që paraprin procesin gjyqësor, sipas të cilit çdo padi është në varësi me të drejtën e kërkuar, për të cilën bën fjalë neni 31 i Kodit të Procedurës Civile... ky rregull i përgjigjet përmbajtjes së nenit 92 të Kodit Civil të harmonizuar me kërkesat e neneve 6 e 28 të Kodit të Procedurës Civile, ose parimit të përputhjes të kërkesave të bëra nga palët me vendimin e dhënë nga gjykata. 39.2. Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik nuk mund të bëhet si kërkim i mëvetësuar; ai gjithnjë duhet të bëhet gjatë gjykimit në themel të një çështjeje nga gjykata, ose të paktën si kërkim që shoqëron zgjidhjen e pasojave të ardhura nga ekzekutimi i tij. 40.1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se nuk mund të paraqitet si padi më vete konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik, sikurse ka vepruar pala paditëse, nëse ky kërkim nuk shoqëron gjykimin e një çështjeje në themel dhe/ose nuk shoqërohet me zgjidhjen e pasojave.*

92/a të Kodit Civil, në vetvete nuk përmbante asnjë mosmarrëveshje, e ka konsideruar padinë pa objekt<sup>83</sup>.

**33.7** Subjekti ka shpjeguar se: *“Roli aktiv i gjykatës në këtë përcaktim të dispozitës/shkakut të padisë mund të përbënte tejkalim të kompetencës së saj, pra të kompetencës së gjykatës në raport me disponimin e padisë sipas objektit të saj. Në lidhje me objektin e padisë, subjekti ka sqaruar se është pasur parasysht (sikurse kam arsyetuar) shkaku ligjor i saj, e drejta mbi të cilën paditësja ka ngritur padinë e saj, mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Referuar vendimit unifikues, është paditësi ai që përcakton në padi bazën ligjore të saj, në raport me mosmarrëveshjen e paraqitur gjykatës për zgjidhje. Pikërisht, raporti disponim i padisë nga paditësi dhe roli aktiv i gjykatës është trajtuar nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr. 5/2012, konkretisht paragrafët 21, 21.1 e 21.2 të tij.*

*Në këto gjykime me këtë natyrë mosmarrëveshjeje, konstatimi i pavlefshmërisë konsiderohet se është i pamjafshueshëm dhe e bën padinë të papranueshme. Në këtë rast padia rrëzohet, unifikojnë Kolegjet e Bashkuara. Pra, nga ana ime (ka theksuar subjekti) është pasur parasysht fakti që për zgjidhjen e pasojave të ardhura nga paligjshmëria e veprimit juridik, rikthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, paditësja nuk ka parashtruar asnjë bazë ligjore, as sipas ligjit të kohës as sipas ligjit në fuqi (Kodi Civil)”.*

**33.8** Subjekti ka sqaruar se në vendimmarrjen e mësipërme ka pasur parasysht provat e administruara në gjykim, hetimin edhe kryesisht nga gjykata të fakteve, pohimet e palës paditëse, të cilat kanë krijuar bindjen e saj të brendshme, në analizë dhe zbatim të ligjit të aplikueshëm në rastin konkret. Subjekti ka sqaruar edhe faktin që në kohën kur është dhënë ky vendim gjykata e faktit nuk mund të dispononte me vendim pushimi për padi që s’mund të ngriheshin, kurse një të drejtë të tillë procedurale e kishte Gjykata e Apelit. Kjo dispozitë (ka vijuar shpjegimet subjekti), neni 299 i Kodit të Procedurës Civile, ka ndryshuar me ndryshimet e ligjit nr. 38/2017. Subjekti ka konfirmuar se *në praktikën e saj gjyqësore, në raste të ngjashme, plotësimin e padisë së pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik (pra në gjykime me të njëjtën natyrë mosmarrëveshjeje), në rast konstatimi të të metave të këtij lloji, sikurse është mungesa e një kërkimi për zgjidhjen e pasojave të paligjshmërisë, referuar konkluzioneve në vendimin unifikues nr. 5/2012, ka kërkuar nga paditësi të shprehet dhe të mbajë qëndrim duke e saktësuar/plotësuar objektin e padisë dhe rast pas rasti ka lënë afat. Ndërsa rasti në fjalë nuk ka të bëjë me plotësimin e të metës së padisë, por me faktin që gjendja e paligjshmërisë nuk ekzistonte më, sipas aktit të ZVRPP-së Tiranë, që vërtetonte pronësinë e vetëm një të padituri dhe jo edhe të dy të tjerëve. Në këtë rast padia është pa objekt, gjë që në parashikimet e sotme procedurale çonte pushimi i gjykimit, si padi që s’mund të ngrihet (neni 299/c i Kodit të Procedurës Civile, ndryshuar me ligjin nr. 38/2017). Subjekti ka shtuar se në rigjykim, paditësi ka shtuar objektin e padisë me një tjetër kërkim, që kishte të bënte me një tjetër pavlefshmeri të transaksionit për pronën objekt gjykimi.*

---

<sup>83</sup> Pika 22 e vendimit nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara: *“...Që padia të merret në shqyrtim nga gjykata duhet të përmbajë në vetvete jo vetëm kërkimin që përbën objektin e saj, por dhe shkakun...Kërkimi për konstatimin e pavlefshmërisë pa treguar të drejtën dhe gjendjen e faktit që i është kundërvënë kësaj të drejte është një padi që në kuptim material, nuk ekziston...”.*

**33.9** Në përfundim, subjekti ka kërkuar që të mbahet në vëmendje natyra e sistemit gjyqësor. Për sa i takon kësaj veprimtarie gjyqësore, si dhe sa i takon pavarësisë që i garantohet gjyqtarit, gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre ka mbajtur qëndrim midis të tjerave edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. \*\*\*, datë 27.5.2004, ku, ndër të tjera, citohet: *“Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, qoftë KLD-ja apo ministri i Drejtësisë, nuk kanë të drejtë të kontrollojnë e vlerësojnë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar edhe praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë. KLD-ja mund të marrë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve pa e kushtëzuar atë me faktin nëse ky vendim ka marrë formë të prerë, vetëm për raste kur vendimet shoqërohen me akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor”*.

**33.10** Subjekti ka depozituar dosjet e gjykimit dhe rigjykimit të padisë së paditëses L.M, vendimin unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimin nr. 11/2004 të Gjykatës Kushtetuese.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**33.11** Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në dosjen gjyqësore, referuar rrethanave të kësaj çështjeje, ka konstatuar se kërkesëpadija ka qënë me shkaqe të paplota (*causa petitionis*), shfaqur si kërkim i paqartë, mbi zgjidhjen e pasojave të ardhura. Duket se paditësja ka paraqitur një kërkesëpadi, me thirrje palësh të paditura të cilat nuk e gëzonin pasurinë objekt gjykimi (formimi i ndërgjyqësisë është një tagër ekskluziv i palës paditëse), përveçse bashkëshortit të saj, pa përcaktuar plotësisht bazën ligjore referuar kërkimin të objektit të padisë, si dhe me mungesë të kërimit të plotë të objektit të padisë për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, etj.

**33.12** Në analizë të dokumentacionit rezulton se subjekti pas konfirmimit të statusit të pasurisë/dyqan, objekt gjykimi, vetëm në emër të bashkëshortit të paditëses dhe jo të dy personave të tjerë të thirrur si palë e paditur, referuar edhe mossaktësimin të objektit të padisë për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke iu referuar vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 5/2012, ka konkluduar në rrëzimin e padisë. Duke iu referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 18.10.2016, i cili ka prishur vendimin e subjektit të rivlerësimit por, më tej, referuar edhe rigjykimit të çështjes në shkallë të parë, trajtimi i çështjes nga subjekti duket se lidhet me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave në gjendjen që ndodheshin aktet dhe brenda kornizës së padisë. Duke vërejtur se në rigjykim paditësja ka shtuar objektin e padisë edhe me pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 21.1.1999, duket se vlerësimi në këtë rast lidhet me çmuarjen e rrethanave faktiko-ligjore dhe me interpretimin e legjislacionit të aplikueshëm.

**33.13** Në këto kushte e rrethana, duke e vlerësuar çështjen nën dritën e objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit<sup>84</sup>, sipas të cilit qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta (për më tepër mbi objekte të padisë jo të njëjtë, për sa kohë është shtuar në gjykimin e Gjykatës së Apelit), nuk mund të jenë kriteri matës vendimtar për vlerësimin e aftësive profesionale të magistratit dhe nuk mund të përdoren për të vlerësuar njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, si një nga nënindikatorët për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në raport me vlerësimin e rrethanave të faktit dhe legjislacionit të aplikueshëm, trupi gjykues nuk konstaton mangësi të një niveli të tillë që mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit.

**33.14** Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara konstatohet se vendimi/et që i përkasin dosjeve nr. 2, 4 dhe 5 dhe janë dorëzuar jashtë afatit ligjor 10-ditor të përcaktuar nga neni 308/2 i Kodit të Procedurës Civile. Dosja me vendimin administrativo-penal është dorëzuar pas 18 ditëve, jashtë afatit ligjor 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Konstatohet se disa seanca nuk kanë rezultuar të dokumentuara me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**33.15** Në shpjegimet e saj subjekti, përveçse e ka konfirmuar të drejtë këtë konstatim, ka kërkuar që trupi gjykues të mbajë në vëmendje, në lidhje me vonesat në arsyetimin e vendimeve, disa faktorë të cilët padyshim kanë ndikuar në këtë vonesë. Subjekti ka argumentuar mbi ngarkesën e lartë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2010 (kur ajo ka filluar punë në këtë gjykatë) e më pas 2016, që ka qenë një fakt i njohur.

**33.16** Subjekti ka konfirmuar se gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Dhomën Civile. Gjatë tri viteve të vlerësimit (ka theksuar se ka depozituar pranë Komisionit të dhënave statistikore) është ngarkuar të gjykojë gjithsej 1777 çështje, ka përfunduar gjithsej 1431 prej tyre për 3 vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 127 çështje të vitit 2016. Nga këto, 617 çështje civile me palë kundërshtare, 542 kërkesa civile, 3 çështje penale themeli, 3 kërkesa penale dhe 303 masa sigurimi. Subjekti, pasi ka pasqyruar një panoramë të ngarkesës së punës, ka deklaruar se rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në të dhënat statistikore është 80,5%, duke sqaruar se, sikurse konstatohet në raport, ngarkesa është dukshëm mbi nivelin e standardit minimal. Lidhur me konstatimin e drejtë në raport me vonesën në arsyetimin e vendimit, ka risjellë në vëmendje edhe një herë se volumi i madh i çështjeve në gjykim, kryesisht për periudhën 2013 – 2016 e në vijim, ka ndikuar në shtyrjen e afateve të gjykimeve dhe të arsyetimit në kohë të vendimeve. Subjekti ka theksuar gjetjen dhe konstatimin në raportin profesional, ku thuhet se *niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor dhe se nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Në këtë këndvështrim, ajo ka nënvizuar se arsyetimi i vendimit përbën një

---

<sup>84</sup> Sikurse shprehet Kolegji në vendimin e saj nr. 28, datë 23.10.2020, konkretisht në pikën 12.5.

element të rëndësishëm të procesit gjyqësor, që i jep rrugë çdo pretendimi të palëve ndërgjyqëse, ashtu sikurse edhe vetë Komisioni ka arsyetuar në vlerësimet profesionale të subjekteve. Kjo rëndësi e këtij procesi, kujdesi që duhet treguar në arsyetimin e plotë të vendimeve që shoqërohet edhe me vijueshmërinë e vlerësimit në gjykatat më të larta, është gjithashtu edhe një nga arsyet e ndonjë vonese të diktuar në arsyetimin dhe depozitimin e vendimeve gjyqësore në tri dosjet e cituara në rivlerësimin profesional, përveç volumit të lartë të punës, i parashtruar më sipër.

**33.17** Në lidhje me zhvillimin e seancave me audio, subjekti ka theksuar se: *“Për shkak të numrit të vogël të sallave që disponon godina e Gjykatës së Tiranës, jo të gjitha seancat arrijnë të zhvillohen me regjistrim audio. Ky ka qenë shkak kryesor dhe i vetëm i kësaj anomalie, pasi absolutisht nuk ka pasur përpjekje për mostransparencë, përkundrazi. Për këto arsye (është shprehur ajo), duke besuar në vlerësimin pozitiv dhe me realitet të situatës, kërkoj nga ana juaj që gjetjet në këtë aspekt të raportit profesional të mos konsiderohen për të më penalizuar si subjekt rivlerësimi”.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**33.18** Trupi gjykues, lidhur me vonesat në arsyetimin e vendimeve në raport me shpjegimet e subjektit, vlerëson ngarkesën e çështjeve, bazuar në të dhënat statistikore të dokumentuara, të cilat kanë qenë të një niveli të lartë. Në kushtet kur niveli i arsyetimit të vendimit konkurren me kohën e kërkuar që nevojitet për arsyetim, për shkak të problematikës së çështjes gjyqësore, kohës që ajo ka marrë për gjykim, volumit të provave të depozituara dhe që duhen arsyetuar etj., vonesa e diktuar duket të jetë e argumentuar dhe në dobi të nxjerrjes së një vendimi të qartë, të plotë, të kuptueshëm dhe mirarsyetuar. Një parashikim i mëvonshëm që shtriu kohën e arsyetimit të vendimit në 20 ditë<sup>85</sup>, edhe pse nuk i përket kohës së vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit, është një tregues që pasqyron rëndësinë që merr arsyetimi i vendimit.

**33.19** Në përmbushje të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, referuar indikatorit të aspektit të arsyetimit ligjor mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të subjektit të rivlerësimit mbi rrethanat të cilat e kanë çuar në vendimmarrjet konkrete, mbahet në konsideratë jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë.

**33.20** Referuar tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve gjyqësore mbi të cilat u konkludua lidhur me këto vonesa, vihet re që në tërësinë e tyre vendimet, edhe pse janë ankimuar, kryesisht kanë mbetur në fuqi nga gjykatat e shkallëve më të larta. Në këto rrethana, vonesat e diktuar të cilat

---

<sup>85</sup> Neni 308 (ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017): *“...Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër”.*

janë vërejtur në tejkalime të vogla të afatit kohor duken të justifikuar, edhe për sa kohë vendimet nuk janë cenuar nga gjykatat më të larta. Në kushte të tilla, duket se këto momente që përmbyllin një fazë të rëndësishme të zhvillimit të një procesi gjyqësor dhe që kërkojnë përkushtim dhe kohë studimore nuk mund të ndikojnë në penalizim të subjektit të rivlerësimit në vlerësimin e aftësisë së saj profesionale.

**33.21** Sa i përket zhvillimit të të gjitha seancave me audio, konsiderohet shpjegimi i subjektit se kjo situatë ka ndodhur për shkak të numrit të vogël të sallave që disponon godina e Gjykatës së Tiranë, duke mos pasur në këtë mënyrë gjykata komoditetin për të realizuar çdo seancë me regjistrim audio. Numri i konsiderueshëm i çështjeve gjyqësore, tashmë i njohur edhe publikisht në media, duket të jetë një faktor tjetër ndikues në këtë situatë. Edhe raporti profesional e cilëson këtë konstatim njëjtë sikurse ka pretenduar subjekti i rivlerësimit se në këtë situatë mund të ketë ndikuar edhe gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numrin e pamjaftueshëm të sallave të gjykimit.

**33.22** Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Fatime Deçolli janë paraqitur 11 ankesa (2 në vitin 2013, 6 në vitin 2014 dhe 3 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së. 2 ankesa (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura. 9 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë: (i) për 2 ankesa (1 e vitit 2013 dhe 1 e vitit 2014), të verifikuara për zvarritje gjykimi, i është tërhequr vëmendja me shkrim gjyqtares; (ii) 1 ankesë e vitit 2013, e verifikuar për zvarritje gjykimi, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje; (iii) 1 ankesë e vitit 2014, e verifikuar bazuar mbi informacionin periodik të ardhur nga kryetari i gjykatës për mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore të arsyetuara, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; (iv) 1 ankesë e vitit 2014, e verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mosrespektim formal të ligjit, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; (v) 2 ankesa të vitit 2014, të verifikuara për zvarritje gjykimi, i janë regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik; (vi) 1 ankesë e vitit 2016, e verifikuar për shkelje etike, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje; (vii) 1 ankesë e vitit 2016, e verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

**i.** KLGJ-ja<sup>86</sup> ka përcjellë praktikën lidhur me ankesat e lartpërmendura, të trajtuara prej saj.

**ii.** Nga verifikimi i secilës praktikë rezultoi si vijon:

**a.** Mbi ankesën nr. \*\*\*, datë 29.12.2011, të Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë “A” sh.a., mbi pretendimin për veprimtarinë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjes civile me objekt “Shpërblim dëmi”<sup>87</sup>, ku kjo shoqëri është në cilësinë e palës së paditur, Inspektorati i KLD-së pas verifikimit ka konkluduar se gjykimi i çështjes ka përfunduar për 8 muaj e 27 ditë, fakt që përbën shkelje të afatit të parashikuar në nenin 5, shkronja “e” e vendimit të KLD-së, nr. 261/2, datë 14.4.2010, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, afat ky që nuk duhet të kalojë më shumë se 6 muaj. Për këtë shkak, mbi propozimin e Inspektoratit të KLD-së, subjektit i është tërhequr vëmendja me shkrim, për t’u përdorur ky akt në vlerësimin e saj profesional dhe etik. Kjo

<sup>86</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>87</sup> Përfunduar me vendimin e subjektit të rivlerësimit nr. \*\*\*, datë 27.12.2011.



edhe pasi nga Inspektorati shkelja është quajtur e pamjaftueshme për t'u trajtuar si shkelje disiplinore.

**b.** Mbi ankesën<sup>88</sup> e shtetasve G.S dhe A.B, për shkelje të solemnitetit dhe zvarritje të gjykimit, në lidhje me çështjen civile me objekt “Lirim dhe dorëzim trualli”, ku ankuesit kanë cilësinë e palës paditëse, është konkluduar në evidentimin e problematikës/shkeljes për tërheqje të vëmendjes me shkrim, akt i cili është bërë pjesë përbërëse e vlerësimit etik dhe profesional të saj, për shkak se shkeljet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të iniciuar në mënyrë të përshtatshme një procedim disiplinor. Ka rezultuar se shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë të justifikuar, porse gjykimi ka zgjatur mbi afatin 6-mujor. Evidentohet edhe ngarkesa e lartë e punës për vitin 2013. Është konkluduar edhe mbi pretendimin për shkeljen e solemnitetit, pasi nga ankuesit është pretenduar për shpallje të vendimit pa sekretare, fakt i cili nuk ka rezultuar i tillë nga të dhënat e sekretares dhe subjektit të cilat janë pyetur për këtë pretendim. Për pasojë, ankesa lidhur me këtë pretendim është arkivuar.

**c.** Mbi ankesën<sup>89</sup> e kryetarit të gjykatës lidhur me dorëzimin me vonesë të vendimit të arsyetuar nr. \*\*\*, datë 30.10.2013, që i përket një dosjeje gjyqësore civile. Sipas informacionit, vendimi i arsyetuar është dorëzuar 17 ditë me vonesë, në kundërshtim me nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile. Nga shpjegimet e subjektit në material rezulton se kjo vonesë ka ardhur për shkak të ngarkesës, e cila është konfirmuar edhe nga inspektimi i kryer, pasi në të njëjtën datë ka rezultuar se janë dorëzuar edhe 14 dosje të tjera të arsyetuara. Në këto kushte, pas shpjegimeve të subjektit, shkaqeve të argumentuara, praktika është arkivuar, duke iu evidentuar kjo problematikë për efekt të vlerësimit profesional.

**ç.** Mbi ankesën<sup>90</sup> e shtetasës I.G, për zvarritje të gjykimit të çështjes civile, me objekt “Kundërshtim të veprimeve përmbarimore dhe pezullim të tyre”, ku ankuesja ka qenë në cilësinë e paditëses, është konkluduar në evidentimin e problematikës/shkeljes për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të saj, kryesisht për kohëzgjatje të shtyrjes së seancave nga njëra tek tjetra rreth 9 muaj dhe, për pasojë, zgjatje e gjykimit në tejkalim të afatit 6-mujor.

**d.** Mbi ankesën<sup>91</sup> e shtetasit T.K, për zvarritje të gjykimit të çështjes civile që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 23.7.2013, është konkluduar në evidentimin e problematikës për t'u marrë në konsideratë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Në praktikë rezulton të jenë evidentuar shkaqet dhe arsyet e zgjatjes së gjykimit për më shumë se dy vite, duke identifikuar se në vitet 2011 – 2013 ngarkesa e gjyqtarës ka qenë e një niveli të lartë dhe se prej saj janë bërë përpjekje reale për zhvillimin e gjykimit. Kryesisht ka rezultuar se seancat janë shtyrë me kërkesë të ankuesit (16 të tilla).

**dh.** Mbi ankesën<sup>92</sup> e shtetasit A.P, shoqëria “M-T” sh.p.k. etj., për zvarritje gjykimi, për çështjen që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 17.4.2015, është konkluduar në evidentimin e

---

<sup>88</sup> Nr. \*\*\*, datë 9.5.2014.

<sup>89</sup> Nr. \*\*\*, datë 12.2.2014.

<sup>90</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2014.

<sup>91</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2014.

<sup>92</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2014.

problematikës/shkeljes për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të saj, kryesisht për kohëzgjatje të shtyrjes së seancave nga njëra tek tjetra dhe, për pasojë, ka ardhur zgjatja e gjykimit në tejkalim të afatit 6-mujor.

e. Mbi ankesën<sup>93</sup> e shtetasit P.T, për zvarritje të gjykimit të çështjes civile që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 17.6.2016, me objekt gjykimi “Zgjidhje e kontratës së sipërmarrjes...”, ku ankuesi ka qenë në cilësinë e palës së paditur, është konkluduar se tejkalimi i afatit të gjykimit dhe shkaqet që kanë sjellë atë t’i evidentohen subjektit/gjyqtares si e dhënë statistikore për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të saj. Kjo për faktin se nga inspektimi i kryer është konfirmuar që thuajse të gjithë shtyrjet e seancave kanë ardhur si rezultat i kërkesave të vetë palëve ndërgjyqëse, përfshirë edhe ankuesin. Konkluzioni është trajtuar në kuadër të: (i) kompleksitetit të çështjes, ku gjykimi është zhvilluar midis një personi juridik dhe tre të paditurve, nga të cilët dy individë, një institucion shtetëror dhe një person i tretë, dhe se vetë mosmarrëveshja krijon vështirësi të gjykimit; (ii) sjelljes së vetë ankuesit, i cili ka rezultuar të jetë pengesë e procesit gjyqësor, pasi disa herë përfaqësuesi i tij ka kërkuar shtyrje, përjashtim të trupit gjykues, ka nënshkruar njoftimin për njërin prej të paditurve të tjerë, arsye e cila ka çuar gjykatën në bërjen e njoftimit me shpallje etj.; (iii) planifikimit dhe organizimit të punës nga subjekti, ku ka rezultuar se dy seanca janë shtyrë për mungesë të gjyqtares për arsye të dokumentuara. Në këtë rast është vlerësuar se vonesa në gjykim ka ardhur për shkaqe të justifikuar proceduralisht dhe të domosdoshme në zgjidhjen e çështjes. Përgjithësisht është konkluduar se seancat kanë qenë produktive.

**33.23** Për sa më sipër, Komisioni edhe pse kreu verifikime dhe ka analizuar më sipër secilën ankesë, ftoi subjektin të vijonte të jepte shpjegime dhe të dokumentonte mbi konkluzionet e dala nga ankesat e trajtuara nga KLD-ja.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**33.24** Në shpjegimet e saj, subjekti ka parashtruar se: *“Pavarësisht konstatimeve dhe gjetjeve të KLD-së (të trajtuara prej saj), sikurse rezulton në raportin profesional, përgjatë karrierës time mbi 30-vjeçare në sistem si gjyqtare, nga ana e organeve të kontrollit nuk rezulton të kem pasur asnjë procedim disiplinor, madje asnjë kërkesë për procedim disiplinor, për shkak të ushtrimit të detyrës. Me këtë dua të sqaroj dhe theksoj faktin që për të gjitha inspektimet e ushtruara nga organet e kontrollit, për të cilat jam vënë në dijeni si për fillimin ashtu edhe përfundimin e tyre, sikurse konstatohet, nuk ka pasur vend për masa disiplinore, sepse nuk ka pasur shkelje gjatë punës time si gjyqtare. Në kryerjen e detyrës kam përballuar ngarkesën maksimale në punë, të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, duke mos lejuar kryerjen e asnjë veprimi apo mosveprimi që krijonte për fajin tim, me dashje apo nga pakujdesia, zvarritje të procesit gjyqësor. Kjo gjë dokumentohet nga përfundimet e inspektimeve, të cilat janë parashtruar gjerësisht dhe hollësisht nga ana juaj në këtë raport”.*

**33.25** Në të gjitha rastet e përshkruara në raport nga inspektori i KLD-së është arritur në konkluzionin që “Rasti nuk përbën shkelje”, referuar ligjit material të kohës, nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, por është

---

<sup>93</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017.

konkluduar në evidentimin e problematikës për t'u marrë në konsideratë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të subjektit (gjqqtarës së çështjes).

**33.26** Subjekti në lidhje me këtë konstatim ka referuar jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me përcaktimin e kriterëve, cenimi i të cilave passjell shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm (parashikimi i nenit 32 të ligjit nr. 9877/2008).

**33.26.i** Sipas Gjykatës Kushtetuese: *“...arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuetit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuetin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit...”* (vendimi nr. 45, datë 19.7.2016, i Gjykatës Kushtetuese). Edhe në lidhje me *“kompleksitetin e çështjes”, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, ka dhënë një vlerësimin të saj, i cili vlen të përmendet meqë bën fjalë për situatën për të cilën po jap shpjegime. Konkretisht: “...në vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme...”*.

**33.27** Subjekti ka kërkuar që për çdo rast të hetuar Komisioni të marrë në analizë secilin prej këtyre kriterëve: *kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve/kërkuetit, sjelljen e autoriteteve dhe rrezikun që passjell për kërkuetin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit*. Subjekti ka theksuar se nga vetë inspektori, rast pas rasti në çështjet e evidentuara, referuar këtyre përcaktimeve, nuk janë konstatuar shkelje të cilat të përbënin shkak për fillimin e procedimit disiplinor, sipas parashikimit të nenit 32/a të ligjit nr. 9877/2008.

**33.28** Sikurse është konstatuar nga e ish-KLD-ja, por edhe nga Komisioni në këtë raport, rezultojnë gjithsej 7 ankesa, pasi 4 janë arkivuar, sepse për to nuk kanë rezultuar shkelje. Subjekti ka shpjeguar kryesisht për kohëzgjatjen e gjykimit përtej afatit 6-mujor të parashikuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së *“Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”*.

**33.28.i** Ajo ka evidentuar faktin se një prej 7 ankesave i përket një gjykimi të vitit 2011 dhe jo periudhës së vlerësimit 2013 – 2016, ndaj për këtë shkak ka kërkuar të vlerësohet që ky gjykim nuk mund të jetë pjesë e këtij raporti, edhe pse ka saktësuar se ky moment është në vlerësim të Komisionit.

**33.28.ii** Në lidhje me afatet e gjykimit, të cilat rezultojnë të jenë shkelur, gjatë gjykimeve respektive, subjekti ka sqaruar se këto zgjatje janë për shkak të natyrës së çështjeve rast pas rasti, të cilat në tërësinë e tyre evidentohen si: *çështje komplekse, me sjellje jokorrekte të palëve/kërkuetit etj., në gjykim etj.*

**33.29** Subjekti ka sjellë në vëmendje se në këndvështrimin e saj procesi gjyqësor nuk ka qëllim në vetvete ruajtjen e standardit të afatit të gjykimit, por garantimin e të drejtës kushtetuese për një

proces të rregullt ligjor. Zhvillimi i gjykimit brenda nja afati të arsyeshëm ligjor përbën sigurisht një nga elementet thelbësore në arritjen e këtij objektiv, por ai nuk është i vetmi ndaj dhe nuk mund të ketë prioritet mbi elementet e tjera të gjykimit, sikurse janë kontradiktorialiteti, thirrja dhe dëgjimi i palëve, shqyrtimi i kërtimeve në raport me prapësimet, marrja dhe shqyrtimi i provave, të cilat së bashku, në çështje me natyrë komplekse, apo me sjellje palësh jokorrekte, padyshim kërkojnë dhe marrin kohën e duhur, në tejkalim të afateve teorike. Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se *për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (vendimi nr. 45, datë 19.7.2016, i Gjykatës Kushtetuese)*. Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013<sup>94</sup>, në lidhje me faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e një gjykimi, faktorë të cilët janë vërejtur edhe në çështjet në fjalë.

**33.30** Në lidhje me evidentimin e problematikës për t'u marrë në konsideratë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të subjektit, të Inspektoratit të KLD-së, subjekti ka parashtruar se nga shqyrtimi i tyre del se inspektori, në këtë konkluzion të tij, bazohet në nenin 34 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë", aktualisht e shfuqizuar<sup>95</sup>. Për këtë çështje subjekti ka theksuar se ky parashikim i rregullores, i cili është shfuqizuar më pas nga vetë KLD-ja (vendimi nr. 48/2016 i KLD-së), përbënte një parashikim tërësisht në kundërshtim me parashikimet e nenit 14, pika 1 e ligjit nr. 8811/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë" (ligji në bazë dhe për zbatim të të cilit ka dalë kjo rregullore), pasi del tërësisht jashtë fushës së veprimtarisë që duhet të rregullonte ky akt (organizmi, funksionimi dhe përcaktimi i numrit të inspektorëve të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë). Parashikimi i kësaj rregulloreje në fakt nuk rregullonte vetëm organizmin, funksionimin dhe numrin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por gjithashtu zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i njëjtit e drejta që t'i tërheqë vëmendjen

---

<sup>94</sup> "...Respektimi i afatit të arsyeshëm ligjor, varet nga shumë faktorë të procesit të gjykimit, të cilët janë të lidhur dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e këtij procesi, siç mund të jenë: sjellja e palëve në proces, kompleksiteti i çështjes, përkushtimi dhe aftësia e gjykatës dhe administratës gjyqësore për përfundimin në kohë të procesit dhe ushtrimin e detyrës në përputhje me ligjin etj... Procesi gjyqësor në vetvete mund të ndahet në dy segmente kohore: (1) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimet procedurale që duhet të ndërmarrin palët në proces; (2) atë/ato segmente kohore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e gjyqtarit, duke zbritur nga e gjithë kohëzgjatja reale e procesit gjyqësor afatin kohor që i atribuohet gjyqtarit dhe aparatit gjyqësor për mbylljen përfundimtare të procesit. Jo e gjithë periudha kohore që i atribuohet gjyqtarit brenda një procesi gjyqësor (si pjesë e punës së tij), në kuptimin e përmendur më sipër, mund të konsiderohet automatikisht si tej afatit të arsyeshëm. Në fakt, çdo proces gjyqësor, edhe ai që kryhet dhe përfundon shpejt, ka kohëzgjatjen e tij normale, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejt si me kryerjen e disa fazave procedurale, ashtu dhe me gjykimet e çështjeve në disa nivele gjykatash (sipas rastit). Në mënyrë që afatet kohore të konsiderohen të paarsyeshme, nuk mjafton vetëm të merret për bazë e gjithë kohëzgjatja reale e procesit, por duhen verifikuar rast pas rasti veprimet konkrete që janë ndërmarrë në kuadër të këtij procesi dhe nëse këto veprime justifikojnë apo jo vonesën dhe neglizhencën e gjyqtarit".

<sup>95</sup> Në të cilën parashikohej se: "2. Nëse çmohet se rasti i verifikuar është i pamjaftueshëm apo ajo shkelje e konstatuar nuk është thelbësisht e tillë që mund të iniciohet përshtatshëm një procedim disiplinor, gjyqtarit konkret i tërhiqet vëmendja me shkrim, duke u bërë ajo pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit dhe e përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të tij. 3. Në çdo rast, raportet apo tërheqjet e vëmendjes, përcillen nëpërmjet zëvendëskryetarit".

gjqtarëve për sjellje që nuk parashikoheshin nga ligji si shkelje disiplinore shumë të rënda, të rënda apo të lehta dhe ta vendoste këtë në dosjen personale të gjyqtarit.

**33.31** Subjekti ka qartësuar se vetë ligji nr. 8811/2001 nuk ka në asnjë rresht të tij një parashikim të tillë ku me rregullore Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i njëjtoj e drejta të evidentonte dhe, për rrjedhojë, të rregullonte karrierën dhe vlerësimin profesional, etik të gjyqtarëve nëpërmjet një procedure të tillë. Një rregullim i tillë vjen ndesh me normat kushtetuese, nenet 145 e 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me parimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor, si dhe të kompetencave të KLD-së si i vetmi organ kushtetues që vendos për të disponuar për masat ndaj gjyqtarit dhe karrierën e tij. Për këtë shkak subjekti ka kërkuar që ky qëndrim i inspektorit, në çështjet e evidentuara më sipër, nuk duhet të merret parasysh.

**33.32** Subjekti ka konfirmuar se për këtë konstatim dhe parashtrimi i është referuar edhe dy vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, në të cilat është konstatuar paligjshmëria dhe, për pasojë, pavlefshmëria e akteve të inspektorit me këtë natyrë, sikurse akti në fjalë (sikurse janë konstatimet në çështjet e inspektuara nga KLD-ja).

**33.33** Subjekti ka depozituar: (i) vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese; (ii) vendimin nr. \*\*\*, datë 10.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; (iii) vendimin nr. \*\*\*, datë 24.2.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; (iv) vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**33.34** Trupi gjykues, pas analizimit të ankesave, dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të mëtejshme të subjektit, në tërësi ka vërejtur se shkaqet dhe arsyet e vonesave të pasqyruara në gjykimin e çështjeve kanë qenë në shumicën e rasteve për shkak të sjelljes së vetë palëve, kompleksitetit të çështjeve, ku janë përfshirë rrethi i shumtë i palëve ndërgjyqëse, kërkesat për shtyrje, përfaqësime, depozitime kundërpadie, raste të kthimit të padisë për të plotësuar të metat e saj, koha e nevojshme për marrje eksperti, njohja, debatimi i provave dhe diskutimi i aktit, koha e nevojshme për gjykim të kërkesave për përjashtim gjyqtari etj.

**33.35** Nga verifikimi i rasteve: (i) ka rezultuar se shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë të justifikuarra, por gjykimi ka zgjatur mbi afatin 6-mujor; (ii) vonesat kanë ardhur për shkak të ngarkesës, e cila është konfirmuar edhe nga inspektimi i kryer, duke u identifikuar se në vitet 2011 – 2013 ngarkesa e saj ka qenë e një niveli të lartë dhe se prej saj janë bërë përpjekje reale për zhvillimin e gjykimin; (iii) shtyrjet e seancave nga njëra tek tjetra në kohë kanë sjellë zgjatjen e gjykimin në tejkalim të afatit 6-mujor; (iv) në një rast është konfirmuar që thujse të gjitha shtyrjet e seancave kanë ardhur si rezultat i kërkesave të vetë palëve ndërgjyqëse, përfshirë edhe ankuesin, dhe konkluzioni është trajtuar në kuadër të: (a) kompleksitetit të çështjes, ku gjykimi është zhvilluar midis një personi juridik dhe tre të paditurve, nga të cilët dy individë, një institucion shtetëror dhe një person i tretë, dhe se vetë mosmarrëveshja krijon vështirësi të gjykimin; (b) sjelljes së vetë ankuesit, i cili ka rezultuar të jetë pengesë e procesit gjyqësor, pasi disa herë përfaqësuesi i tij ka kërkuar shtyrje, përjashtim të trupit gjykues, ka nënshkruar njoftimin për njërin prej të paditurve të tjerë, arsye e cila ka çuar gjykatën në bërjen e njoftimit me shpallje etj.

**33.36** Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit të dosjeve, ekziston një jurisprudencë e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese lidhur me përcaktimin e kritereve, cenimi i të cilave passjell shkëlqje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Kjo gjykatë ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit.

**33.37** Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme, sikurse shprehet edhe vendimi nr. 45, datë 19.7.2016, i Gjykatës Kushtetuese. Edhe duke iu referuar rasteve, në të shumtën e tyre vërehet se tejkalimi i afatit është me dy muaj, tre apo jo më shumë se një vit, në raport me afatin 6-mujor të parashikuar në nenin 5, shkronja “e” e vendimit të KLD-së nr. 261/2, datë 14.4.2010, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”<sup>96</sup>.

**33.38** Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, konstaton se ky i fundit ka sqaruar në mënyrë të hollësishme elementët përbërës që duhen mbajtur në vëmendje përgjatë një procesi gjyqësor, duke iu referuar edhe jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese apo edhe të GJEDNJ-së, të cilët në mënyrë konstante ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, si: (i) kompleksiteti i çështjes; (ii) numri i konsiderueshëm i palëve ndërgjyqëse; (iii) ushtrimi i të drejtave të tyre për të shtuar, pakësuar apo saktësuar objektin e padisë, siç edhe ka ndodhur; (iv) kërkitimi për përfaqësime/mbrojtje ligjore, njohjet me kërkesat e njëpasnjëshme, përfshirë edhe depozitime të kundërpasive etj., veprime të cilat marrin kohën e tyre, përmbushin të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqëse për një proces të rregullt ligjor, lejojnë gjykatën të ndërmarrë veprime procedurale, vendimmarrje të ndërmjetme kur ligja e njeh dhe e kërkon, por që në përfundim ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, problematikë e cila nuk mund t’i adresohet subjektit.

**33.39** Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues vëren se tërësia e arsyeve që kanë diktuar nevojën për shtyrjen e seancave gjyqësore dhe daljen e gjykimit jashtë afateve të parashikuara nga standardet kohore të vlerësimit sipas vendimit të KLD-së nr. 261/2, datë 14.4.2010, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, nuk ka ardhur për arsye të subjektit, shkaqe të pajustificuara të saj apo të lindura nga aspekte subjektive po të saj, por si rrjedhojë e garantimit të standardeve të komponentëve të procesit të rregullt ligjor.

**33.40** Edhe dy vendimet gjyqësore të depozituara nga subjekti si rezultat i padive të një gjyqtari në të cilat është konstatuar paligjshmëria dhe për pasojë pavlefshmëria e akteve të inspektorit me këtë natyrë, sikurse janë konstatimet në çështjet e inspektuara nga KLD-ja, të adresuara për

---

<sup>96</sup> Afatet e caktuara nga ish-KLD-ja, ishin afate orientuese dhe jo detyruese për gjyqtarët. Afatet ligjore të gjykimit, detyruese, janë ato të caktuara nga neni 399/2 i K.Pr.Civile. Sipas kësaj dispozite: “1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen: (...) b) në gjykimin civil në shkallë të parë përfundimi i procesit të gjykimit brenda dy viteve; (...).”.

vlerësim etik dhe profesional, pasi ka rezultuar se në vlerësim është dalë tërësisht jashtë fushës së veprimtarisë që duhet të rregullonte rregullorja e brendshme e KLD-së për organizmin, funksionimin, përcaktimin e numrit të inspektorëve të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duket se përbëjnë premisë në rrethanë favorizuese të subjektit lidhur me peshën e konstatimeve të Komisionit për këtë çështje.

**33.41** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Fatime Deçolli përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë pasur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

**33.42** SPAK-u<sup>97</sup> ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i kryer në regjistrat përkatës, të njoftimit të veprave penale kësaj prokurorie, nuk ka rezultuar i regjistruar ndonjë procedim penal.

### **Në lidhje me denoncimet e depozituara në Komision, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016**

**34.** Komisioni, pasi administroi denoncimet e depozituara nga shtetas të ndryshëm dhe pasi i trajtoi dhe hetoi gjerësisht rast pas rasti, sipas tipologjive të tyre, konstatoi:

**34.1** Në 5 raste denoncuesit<sup>98</sup> ankohen për zvarritje të procesit gjyqësor.

**i.** Për një rast/çështje gjyqësore<sup>99</sup>, me objekt “Përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga një kontratë e kalimit të të drejtave dhe detyrimeve lidhur mes tyre...”, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara në pyetësor<sup>100</sup>, duke iu referuar veprimeve procedurale të kryera, të pasqyruara në procesverbalet e seancave, si dhe ka depozituar prova. Nga verifikimi i akteve, çështja paraqitet komplekse dhe voluminoze. Nga trajtimi i tyre ka rezultuar se çështja kryesisht i përkiste konfliktit pronësor. Çështja dallohet nga numri i palëve ndërgjyqëse, kompleksiteti i saj, sjellja e vetë palëve në gjykim, depozitimi i kundërpadisë, kërkesa për sigurim padie, paraqitja e kërkesave të tjera të ndryshme, si dhe mosformimet e trupës gjyqësore disa herë për shkak të ndryshimit të anëtarëve si pasojë e procesit të vetingut, etj. Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar në përgjithësi, nuk janë provuar pretendimet e denoncuesit. Është vërejtur se shtyrjet e seancave kanë ardhur kryesisht nga kërkesat e palëve për t’u përfaqësuar në gjykim nga avokatë, apo edhe duke i ndërruar disa herë ata, por edhe për shkak të kërkesave për përjashtim të trupës gjyqësore, të depozitimit të prova të ndryshme etj., veprime të cilat marrin kohën e tyre, përmbushin të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqëse për një proces të rregullt ligjor. Thuajse në të gjithë rastet e kërkesave për përjashtim të subjektit apo trupës gjyqësore, kërkesat janë rrëzuar. Nga verifikimi i vendimit të rrëzimit të kërkesës *për përjashtim gjyqtari*, është konstatuar se, nga gjykata është argumentuar në çdo rast çdo pretendim i palës në gjykim.

<sup>97</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 26.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>98</sup> Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2023, i shtetasit B.L, nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2022, i shtetasit I.K, nr.\*\*\* prot, datë 15.7.2020, i R. Bank; [https://www.\\*\\*\\*news.tv](https://www.***news.tv)\*\*\* dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2024, i shtetasit I.D, të administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>99</sup> Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2023, i shtetasit B.L.

<sup>100</sup> Referojuni pyetësorit nr. 5, datë 19.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit ku me shkresën datë 03.05.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konfirmohet se çështja aktualisht ka status të ankimuar.

**ii.** Për 1 denoncim<sup>101</sup>, Komisioni i kërkoi<sup>102</sup> Gjykatës së Apelit Tiranë kopje të dosjes gjyqësore nr. \*\*\* akti, datë 27.7.2020, për të cilën subjekti me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 4.6.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë për çështjen civile, me objekt “Lirim dhe dorëzim të pasurisë objekt të kontratës së shitjes”. Nga verifikimi i akteve të dosjes u vërejt se njoftimet ishin kryer, seancat gjyqësore ishin zhvilluar dhe në çdo rast shtyrjeje kjo kishte ardhur si rezultat i kërkimit të vetë palëve ndërgjyqëse për shkaqe dhe arsye të ndryshme, përfshirë këtu edhe palën paditëse (denoncuese). Nga aktet në dosje dukej se nuk rezultonte shtyrje e seancave për shkaqe të subjektit. Për këtë çështje Komisioni nuk diktoi fakte apo rrethana të cilat mund të përbënin provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**iii.** Ndërsa për tri denoncimet<sup>103</sup> e tjera, subjekti ka konfirmuar dhe ky fakt është provuar<sup>104</sup> se çështjet janë në gjykim, edhe pse për dy prej tyre ka dhënë shpjegime në pyetësor, por ndodhur në të tilla kushte Komisioni ka konkluduar bazuar në nenin E/2 të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se *...vlerësimi i aftësisë profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, se trajtimi i tyre del jashtë kompetencës së këtij institucioni.

**34.2** Në një rast<sup>105</sup> denoncimi nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga verifikimi u konstatua se ishte një kërkesë për arsye të caktuar drejtuar trupës gjyqësore në gjykatë dhe jo denoncim.

**34.3** Në 12 raste<sup>106</sup>, denoncimet kryesisht kanë pasur si objekt pretendimi dhënien e vendimit të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit. Nga trajtimi i tyre, pas verifikimit të pretendimeve dhe dokumentacionit të depozituar, Komisioni ka konkluduar se pretendimet lidhen kryesisht me gjykimin e themelit, debatin gjyqësor të provave etj., dhe në tërësi për to nuk janë identifikuar fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**34.4** Në 3 raste<sup>107</sup> pretendimet në denoncim i referohen njëanshmërisë së shfaqur në gjykim nga subjekti i rivlerësimit. Për këto denoncime, Komisioni i ka kërkuar subjektin në pyetësor<sup>108</sup> të shpjegojë dhe depozitojë dokumentacion.

---

<sup>101</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2020, e R. Bank, administruar në dosjen e Komisionit. Subjekti për këtë çështje ka konfirmuar se ajo disponohet nga Gjykata e Apelit Tiranë mbi ankimin e ushtruar.

<sup>102</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.8.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>103</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2022, i shtetasit I.K, nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2024, i shtetasit I.D, administruar në dosjen e Komisionit dhe sipas aksesit në media [https://www.\\*\\*\\*news.tv/\\*\\*\\*](https://www.***news.tv/***)

<sup>104</sup> Referuar shkresës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë datë 03.05.2024, depozituar me pyetësorin nr.5, datë 19.04.2024; shkresës datë 3.05.2024 depozituar me pyetësorin nr.5, datë 19.04.2024, si dhe shkresës datë 28.05.2024, të po kësaj gjykate, administruar me parashtrimet e subjektit.

<sup>105</sup> Që i përket denoncimit nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2023, të shtetasit E.S, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>106</sup> Nr. \*\*\* prot, datë 23.11.2017; Nr. \*\*\* prot, datë 26.12.2017; Nr. \*\*\* prot, datë 06.03.2018 ; (Nr. \*\*\* prot, datë 05.04.2018, Nr. \*\*\* prot, datë 06.04.2018 dhe Nr. \*\*\* prot, datë 22.07.2019 nga i njëjti denoncues);Nr. \*\*\*prot, datë 30.04.2018; Nr. \*\*\*prot, datë 06.09.2018; Nr. \*\*\* prot, datë 27.02.2019; Nr. \*\*\* prot, datë 30.05.2019; Nr. \*\*\* prot, datë 18.06.2019; Nr. \*\*\* prot, datë 09.10.2019; Nr. \*\*\* prot, datë 15.07.2021, si dhe Nr.\*\*\* prot, datë 13.02.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>107</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018, depozituar nga i njëjti denoncues; nr. \*\*\* prot., datë 2.7.2019; [https://www.\\*\\*\\*nws.tv/\\*\\*\\*](https://www.***nws.tv/***)

<sup>108</sup> Nr. 5, datë 19.4.2024, administruar në dosjen e Komisionit.



**34.4.1** Në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara është vërejtur se çështjet gjyqësore kanë pasur si objekt: (a) Detyrimin e të paditurës për të njohur paditësin trashëgimtar të babait të tij nëpërmjet konstatimit të pavlefshmërisë absolute të testamentit nr. \*\*\*, datë 19.5.2010, marrje e masës së sigurimit të padisë; (b) Detyrim kompensimi për sipërfaqen e zënë me ndërtim mbi truallin në pronësi të paditësve; (c) Kundërshtimin e vendimit të KKKPronave nr. \*\*\*, datë 17.11.1995 dhe se në tërësi pas verifikimit të tyre duket se nuk kanë rezultuar fakte apo rrethana që mund të përbënin shkak për penalizim të subjektit në vlerësimin e aftësisë së saj profesionale.

**i.** Në çështjen e parë ku pretendohet se nga subjekti në gjykim është shkelur ligji, pasi nuk është marrë mendimi i palëve pjesëmarrëse në gjykim për caktim ekspertit, është shkelur e drejta për të thirrur një ekspert tjetër, është shfaqur njëanshmëri etj., në analizë të shpjegimeve të subjektit, dëgjësës së seancës në audio, provave të administruara, u konstatua se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë. Konstatohet se gjykata ka ndjekur procedurën ligjore për caktimin e ekspertit nga lista e IML-së. Reagimet e palëve pas rrëzimit të kërkesës për përjashtimin e ekspertit janë pasuar me paragjykim për njëanshmëri të subjektit në gjykim dhe, në këto kushte, është kërkuar përjashtimi i trupit gjykues, kërkesë e cila pasi është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues i Gjykatës së Rrethit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* akti datë 6.12.2017, është vendosur rrëzimi i saj. Në vendimin e rrëzimit të kërkesës së përjashtimit të gjyqtarit, duket se gjykata ka hetuar në lidhje me pretendimin e paditësit për shkakun e përjashtimit, ka analizuar rrethanat dhe faktet e paraqitura nga kërkuesi/paditës dhe në përfundim i ka gjetur ato të pabazuara. Në këtë situatë, vetë pala ka kërkuar pushimin e gjykimit në bazë të nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile.

**ii.** Në çështjen tjetër<sup>109</sup>, që i përket ankesës së shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., ku pretendohet se është shkelur ligji dhe nuk është vendosur pushimi i çështjes, është adresuar gabim njoftimi tek pala e paditur me qëllim gjykimin e çështjes në mungesë të tyre, është munguar nga subjekti pa arsye, duke u bërë shkak për zvarritje të gjykimit etj., pas shpjegimeve dhe provave të depozituara është konstatuar se vetë pala ankuese është paraqitur pas 11 seancave në mungesë, duke parashtruar kërkesën për pushimin e gjykimit (si gjë e gjykuar, e për rrjedhim padi që s’mund të ngrihet, referuar nenit 299/c të Kodit të Procedurës Civile, ndryshuar me ligjin nr. 38/2017). Pretendimi i denoncuesit për adresimin e gabuar të njoftimit me fletëthirrjen datë 6.06.2019 për seancë po në këtë datë nuk qëndron, pasi Komisioni nga verifikimi konstatoi dy fletëthirrje ku e dyta korrigjonte gabimin në datë për seancën që do të zhvillohej në 21.06.2019. Kjo konfirmohet më së miri edhe nga procesverbali i seancës gjyqësore i mbajtur në datë 31.05.2019 ku cilësohet se seanca e ardhshme është lënë për në datë 21.06.2019. Edhe në lidhje me mungesat e subjektit në gjykim, të pretenduara nga denoncuesi, nga aktet e depozituara duket se ato janë për shkaqe të arsyeshme, qofshin ato shëndetësore (raport) apo ditë nga leje vjetore<sup>110</sup>. Nga aktet në dosjen gjyqësore<sup>111</sup> rezulton se shoqëria “\*\*\*\*” shpk, me administrator F.U (denoncuesi), me vendimin nr.\*\*\*, datë 10.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është dënuar me gjobë në shumën 5.000 lekë, përveç *rrëzimit të kërkesës* për përjashtimin e gjyqtarës/subjektit të rivlerësimit nga

---

<sup>109</sup> Çështje e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e kthyer për rigjykim, e marrë nga subjekti për gjykim, me delegim nga KLD-ja.

<sup>110</sup> Sipas dokumentacionit të depozituar për këtë çështje, në pyetësorin nr.5, datë 19.04.2024.

<sup>111</sup> Depozituar nga subjekti në pyetësorin nr.5, datë 19.04.2024.

çështja objekt hetimi, vendim i cili duket se ka arsyetuar gjerësisht pretendimet e kërkuarit duke i gjetur ato të pabazuara. Çështja rezultoi e përfunduar nga një trupë tjetër gjyqësore pas pranimit nga drejtuesi i gjykatës, të kërkesës së saj për dorëheqje.

**iii.** Në çështjen e trajtuar nga aksesi në media *online*, Komisioni nga informacioni mediatik vërejt se në të referohej një kërkesë e familjes Polena drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë për përjashtimin e gjyqtarës/subjektin e rivlerësimit, sepse ajo kishte gjykuar më parë një çështje tjetër me këtë palë.

**34.5** Trupi gjyqësor, në analizë të të dhënave në akte dhe shpjegimeve të subjektit, konstatoi se në këtë çështje ishte kërkuar disa herë përjashtimi i gjyqtarës nga gjykimi i çështjes dhe se ai në shumicën e rasteve nuk ishte pranuar, duke u argumentuar gjerësisht arsyet nga të tjera subjekte. Nga aktet rezultoi se subjekti kishte gjykuar më parë padinë me nr. \*\*\* akti, datë 28.10.2010 regj., me palë M.P, i paditur Q.T, me objekt “Lirim dhe dorëzim truall” dhe se në këtë çështje pala paditëse në seancë përgatitore kishte hequr dorë nga gjykimi i çështjes, i cili më pas ishte pushuar për mosparaqitje të paditëses dhe ndaj vendimit nuk ishte ushtruar ankimi. Trupi gjyqësor konstatoi se çështja e gjykuar më parë nuk kishte të njëjtat palë dhe as të njëjtin objekt padie. Në këtë rast ankuesit ishin të paditur nga një tjetër familje për kundërshtim të vendimit të KKKPronave, ndërsa në çështjen që i përkiste vitit 2010 ankuesit ishin në cilësinë e paditësve nën objektin e lirimit dhe dorëzimit të truallit.

**34.6** Edhe nga praktika e trajtimit të ankesës në KLD<sup>112</sup>, rezultoi se pasi ishin verifikuar dhe ishte kryer inspektim mbi veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës, në raport me pretendimet e palës, nuk ishte konstatuar vërtetësi dhe bazueshmëri e tyre/prendimeve për sjellje joetike të gjyqtarit kundërshtues të paditurve P, përkundër është konkluduar se gjyqtarja/subjekti i rivlerësimit ka drejtuar seancat me korrektësi dhe paanësi duke zbatuar K.Pr.civile, ndonëse palët kanë qenë të acaruar me njëra tjetrën.

**34.7** Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit.

**35.** Në denoncimin<sup>113</sup> e trajtuar në vijim, Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ i kërkoi subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e pretendimeve të denoncuesit, si dhe të dokumentojë statusin aktual të çështjes gjyqësore (nëse është ushtruar ankimi dhe si ka vijuar më tej procesi).

**35.1** Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit në gjykimin e çështjes civile, me palë ndërgjyqësore paditës SH.L dhe i paditur shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*” sh.a., me objekt “Detyrim shpërblimi për dëmin jashtëkontraktor”, ka qenë i njëanshëm.

**35.2** Denoncuesi nuk cilëson lidhjen ose pozitën e tij në këtë çështje apo me palët në gjykim por, bazuar në shkresën ku është bërë ankimi dhe nënshkrimi, në fund lë të kuptohet se është avokati i shtetasit SH.L. Denoncuesi (ose përfaqësuesi i tij) nuk ka depozituar ndonjë dokument, por në

---

<sup>112</sup> Referuar shkresës *Kthim Përgjigje* nr.\*\*\* prot, datë 23.03.2018, Urdhërit të Inspektoratit, si dhe Procesverbalit për *Pasqyrimin e Veprimit të Verifikimit* të po këtij institucioni, datë 14.07.2016, depozituar nga subjekti me pyetësin nr.5, datë 19.04.2024.

<sup>113</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2019, paraqitur nga shtetasi M.B, administruar në dosjen e Komisionit.

denoncimin e tij ai shprehet se subjekti i rivlerësimit ka shkelur procedurën për marrjen e ekspertit (mjek). Denoncuesi pretendon se gjyqtarja duhej t'i drejtohej IML-së dhe jo ta caktonte ajo vetë dhe se mjeku ekspert është mik i bashkëshortit. Denoncuesi parashtron se ai ka kërkuar edhe përjashtimin e ekspertit, për shkak se midis tyre ka pasur një konflikt më parë, gjë që nuk është pranuar.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**35.3** Subjekti në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka konfirmuar se kjo çështje është në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke vlerësuar në këtë rast aplikimin e parashikimit të nenit E/2 të Aneksit të Kushtetutës, ku shprehimisht thuhet se: “...vlerësimi i aftësisë profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim...”.

**35.4** Por, në vijim, subjekti ka sqaruar se pretendimet e avokatit M.B nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi në vendimin për caktimin e seancës përgatitore datë 2.5.2019 (ku është caktuar data e seancës përgatitore, 25.9.2019), nga ana e saj në cilësinë e gjyqtarit të vetëm për veprimet paraprake, sipas parashikimit të neneve 158/b etj. të Kodit të Procedurës Civile, është pranuar kërkesa e paditësit për marrjen e provës me ekspert, konkretisht vendim për ekspertim mjekoligjor, vlerësues dëmsh shëndetësore dhe autoteknik. Subjekti ka sqaruar se po në këtë vendim ka përcaktuar edhe rrethin e ekspertëve të cilët janë thirrur të paraqiten në të njëjtën seancë (datë 29.5.2019).

**35.5** Subjekti ka sqaruar se mjeku ligjor i thirrur (A. V) ka qenë mjek ligjor pranë IML-së sipas listës që përcjell rregullisht ky institucion pranë kësaj gjykate për efekte të ekspertimeve civile dhe penale që kryen gjatë procesit gjyqësor (aktualisht ky mjek është në pension dhe nuk bën pjesë në listën e ekspertëve të IML-së, por në listën e ekspertëve të licensuar të MD-së).

**35.6** Në vijim, subjekti ka renditur ecurinë e procesit, duke konfirmuar kërkesat për përjashtim të ekspertit nga përfaqësuesi i palës në gjykim, duke parashtruar edhe shkaqet përkatëse në lidhje me këtë kërkim. Kryesisht, paditësi ka pretenduar se ndaj ekspertit ka një çështje penale mbi një kallëzim të tijin, avokatit M.B, fakt i cili sipas tij ndikonte në paanësinë e ekspertit në këtë gjykim. Pala e paditur nuk ka qenë dakord me këtë kërkesë të paditësit. Për të shqyrtuar kërkesën, për të cilën palët dhe eksperti kanë pasur debat (zhvilluar në sallën nr. 20 të Gjykatës së Rrethit Tiranë), gjykata/gjyqtari i vetëm ka ndërprerë seancën, ka shqyrtuar materialet, si dhe pretendimet e palëve dhe në seancën e datës 26.9.2019 (një ditë më pas) është shprehur me vendimin e ndërmjetëm të kësaj date, duke e rrëzuar kërkesën. Subjekti ka cituar pjesë nga arsyetimi<sup>114</sup> i vendimit të ndërmjetëm dhe ka konfirmuar se pas këtij vendimi të ndërmjetëm avokati ka kërkuar kohë për të depozituar kërkesë përjashtimi për gjyqtarin e çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar nga gjykata.

---

<sup>114</sup> “Kërkesa e paditësit nuk rezulton të jetë e bazuar në argumentet përkatëse, sipas parashikimit të nenit 225/4 të Kodit të Procedurës Civile. Konkretisht, nuk rezulton e vërtetuar që ndaj ekspertit A.V të ketë filluar ndonjë procedim penal për kryerjen e aktit të ekspertimit, përkundrazi vetëpaditësi i vërtetoi gjykatës që për kallëzimin e tij ndaj këtij eksperti për ekspertimin e kryer në një gjykim tjetër (pa asnjë lidhje me gjykimin e padisë së A. L), është konkluduar nga organi procedues me vendim mosfillimi të datës 31.7.2019. Nga ana tjetër, gjykata/gjyqtari vetëm ka vlerësuar se edhe në kushtet e ekzistencës së një procedimi penal për ekspertim të rremë apo mosdhënie ekspertimi ndaj ekspertit A. V të caktuar nga gjykata, e dhëna e pretenduar lidhet me përfaqësuesin e palës dhe jo me palën vetë, meqë avokati pretendoi se ishte ai kallëzuesi për kryerje të veprës penale nga A. V...”.

Më tej, në seancën përgatitore të datës 17.10.2019, paditësi ka depozituar kërkesë për pushimin e gjykimit, duke hequr dorë prej tij sipas parashikimit të nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile.

**35.7** Subjekti ka shpjeguar se: *“Procedura e caktimit të ekspertit në këtë çështje është konform parashikimit të nenit 225/4 të Kodit të Procedurës Civile; eksperti është mjek ligjor pranë IML-së sipas listës së këtij institucioni; nuk rezultojnë shkaqe përjashtimi ndaj tij dhe për këtë gjyqtari ka mbajtur qëndrim me vendim; nuk ka shkaqe papajtueshmërie në punën dhe gjykimin e padisë, sepse gjykimi nuk ka palë IML-në, ku është i punësuar bashkëshorti im”,* por ka prova të cilat merren/prodhohen, krijohen nga subjekte të këtij institucioni, të cilët mbajnë përgjegjësi personale për ekspertimin që marrin përsipër të kryejnë.

**35.8** Subjekti ka konfirmuar edhe statusin e çështjes. Konkretisht, pas kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, gjykata/subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.1.2019, ka vendosur pushimin e gjykimit në bazë të neneve 201, 299/b dhe 301 të Kodit të Procedurës Civile dhe se pas ankimit të ushtruar aktualisht çështja administrohet në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**35.9** Subjekti ka depozituar: (i) kopje të dosjes gjyqësore nr. \*\* akti, datë vendimi 10.10.2019; (ii) kopje të dosjes gjyqësore nr. \*\*\* vendimi, datë 17.10.2019 (ku gjenden seancat me vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës); (iii) vërtetim datë 28.5.2024 të k/sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Tiranë mbi statusin e çështjes civile; (iv) fotokopje të dosjes së shqyrtimit të kërkesës së përjashtimit të saj si gjyqtare.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**35.10** Trupi gjykues, paraprakisht shprehet se në këtë rast, nuk qëndron pretendimi i subjektit për aplikimin e nenit E/2 të Aneksit të Kushtetutës, pasi konstaton se në kohën e shqyrtimit të kësaj çështje nga Komisioni, sipas akteve në dosje dhe vërtetimit datë 28.5.2024 të k/sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Tiranë, rezulton se subjekti ka disponuar me vendim, i cili është ankimuar.

Në analizë të shpjegimeve dhe provave të administruara për këtë çështje, trupi gjykues vëren se duken bindëse shpjegimet e subjektit në raport me pretendimet e denoncuesit. Nga verifikimi i akteve në dosje konstatohet se subjekti është shprehur<sup>115</sup> me vendim të ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për përjashtim të ekspertit. Konstatohet se kërkesa për përjashtim të ekspertit ka qenë e lidhur me përfaqësuesin ligjor të palës, për arsye të tij dhe jo për palën që përfaqësonte.

**35.11** Sikurse rezulton nga aktet në dosje, konstatohet se nga njëra anë përfaqësuesi ligjor i palës ka ezauruar mjetet dhe mekanizmat, ndërsa nga ana tjetër edhe gjykata ka vepruar proceduralisht, duke u shprehur me vendimmarrje. Pas rrëzimit të kërkesës për përjashtim të ekspertit, rezulton se denoncuesi/përfaqësuesi i palës së paditur ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, mbi faktin se ajo nuk ka pranuar kërkesën e tij për përjashtim eksperti. Nga aktet e administruara rezultoi se me vendimin nr.\*\*\* datë 10.10.2019 të një subjekti tjetër, kjo kërkesë për përjashtimin e subjektit është rrëzuar. Më tej, denoncuesi ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes me pretendimin se kërkesa e tij për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nuk është pranuar.

**35.12** Duket se ankimi i denoncuesit për të implikuar subjektin në njohje me ekspertin e caktuar për të kryer aktin e ekspertimit, nuk rezulton i provuar, sikurse konstatohet se ai nuk ka mundur të

---

<sup>115</sup> Refero procesverbalin përgatitor datë 26.09.2019

provojë këtë fakt as në gjykimin e kërkesës për përjashtim gjyqtari dhe as në denoncimin e depozituar në Komision. Nga aktet në dosje konstatohet se nga ana e përfaqësuesit të palës së paditëse, me kërkesën nr.\*\*\* datë 16.10.2019, pasqyruar edhe në dokumentin “ procesverbal përgatitor” datë 17.10.2019, është kërkuar pushimi i gjykimit, duke hequr dorë nga gjykimi i çështjes sipas nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se duket se denoncuesi (përfaqësuesi i palës në gjykim) ka synuar të përdorë mekanizma për të përjashtuar subjektin nga gjykimi i çështjes, ku ai vetë ka pranuar pushimin e saj dhe në kushtet kur ringritja e padisë do të kalonte sërish tek i njëjti gjyqtar, ka preferuar/zgjedhur ushtrimin e të drejtës ankimore për të shmangur në vijim këtë situatë .

**35.13** Duke iu referuar vendimit të rrëzimit të përjashtimit të subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i çështjes, thuhet se ankesat janë thjesht intimidime dhe presione haptazi të kundërligjshme që kjo palë po ushtron ndaj trupës gjyqësore me synimin e vetëm të arritjes së qëllimit për përjashtim gjyqtari.

**35.14** Për sa më sipër, trupi gjykues duket se nuk vëren fakte apo rrethana cilat ndikojnë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**36.** Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk janë konstatuar mangësi profesionale, të tilla si mosrespektim i të drejtave të palëve apo të dispozitave që përcaktojnë hapat proceduralë e, për rrjedhojë, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “e aftë”.

### **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit znj.Fatime Deçolli: (a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj.Fatime Deçolli, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 5.6.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**

**Kryesues**

**Brunilda BEKTESHI**

**Relatore**

**Etleda ÇIFTJA**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Albana Plaka*